



Drejtoria Për Mbrojtje, Shpëtim dhe  
Shërbime Publike

09 Nr. \_\_\_\_\_ /2022 | Dt. 05 / 04 /2022

Komuna e Deçanit në bazë të kompetencave dhe nevojave të dala nga kërkesa e DSHP-së për hartimin e planit të veprimit për energji të qëndrueshme bënë këtë:

## THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ-të DHE KOMPANITË PËR HARTIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR ENERGJI DHE KLIMË (PVKEK)

**Termat e referencës për hartimin e planit të veprimit për energji dhe klimë në Komunën e Deçanit përmes thirrjes publike të kompanive dhe OJQ-ve:**

Me hartimin e planit të veprimit për energji dhe klimë (PVKEK). Komuna e Deçanit synon anëtarësimin e komunës në Konventën së Kryetareve (KK). Në fund të janarit të vitit 2008, Komisioni Evropian ka iniciuar ndërlidhjen e kryetarëve të qyteteve (krye bashkiakëve) të qyteteve evropiane për energji dhe klimë në një rrjet të përhershëm me qëllim që të shkëmben përvojat në zbatimin e masave efikase për përmirësimin e eficiencen energetike dhe klimë në mqedise urbane.

Iniciativa e Konventës së Kryetareve (KK) është përgjigjja e qytetarëve, udhëheqësve evropian ndaj sfidave te ndryshimit të klimës globale, dhe në të njëjtën kohe, ajo është nisma me ambicioze e Komisionit Evropian, drejtpërdrejtë e orientuar drejt përfshirjes aktive dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme të administratake Komunale dhe vete qytetarëve në luftën kundër ngrohjes globale. Me nënshkrimin e Konventës, kryetarët e komunave do të angazhohen për zbatimin e masave të shumta te eficiences së energjisë dhe klimës, të cilat në fund do të qojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub>, në qytete e tyre me më shumë se 20% gjer në vitin 2030, siç kërkohet me Propozimin e Politikës Evropiane për Energji dhe Klimë nga viti 2017.

Roli i administratës komunale manifestohet nëpërmjet përgjegjësive vijuese të përcaktuara nga Konventat e Kryetareve (KK):

- 1) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të eficiences së energjisë dhe klimës në ndërtesat publike, në pronësi ose me qira nga komuna;
- 2) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të eficiences së energjisë dhe klimës dhe rruajtjen e mjedisit në sektorin e transportit publik të komunës;
- 3) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të eficiences së energjisë dhe klimës në sektorin e ndriçimit publik të komunës;

- 4) Planifikimi i zhvillimit të qytetit bazuar në energjinë dhe klimën e qëndrueshme;
- 5) Zbatimi i aktiviteteve të vazhdueshme lidhur me mënyrat e rritjes se eficiencës së energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve të CO<sub>2</sub>, me qellim të ngritjes së vetëdijes së qytetareve per nevojën e kursimit të energjisë dhe klimës në të gjitha fushat e jetës dhe punës;
- 6) Mbështetja e programeve dhe nismave të personave të ndryshëm fizik dhe juridik me qellim të rritjes së përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë;
- 7) Promovimi i prodhimit vendor të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe kogjenerimi.

### **Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së ofruesit të shërbimeve :**

Kriteret e përgjithshme të thirrjes për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) për Komunën e Deçanit ka paraparë një numër të kushteve të përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojë ofruesi i shërbimeve (aplikuesi). Përmes vendosjes së këtyre kushteve të përgjithshme aplikohen standartet minimale formale të cilat kerkohen të plotësohen nga ofruesi I shërbimeve I cili do të hartoje PKVEK-në të Komunës së Deçanit sipas kritereve të kerkuara dhe marrëveshjes me GIZ.

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësohen nga ofruesi I shërbimeve (aplikuesi) janë:

1. Të ketë çertifikatën e regjistrimit të biznesit në vandin e themelimit (vetëm për kompani ndërsa nuk vlen për OJQ, për OJQ duhet çertifikata e OJQ-së)
2. Të ketë çertifikatën e numrit fiskal (kompani apo OJQ)
3. Të ofrojë dëshmi për Pagesat e rregullta të tatimeve; provat që duhet të dorëzohen janë dëshmitë nga ATK (konform LPP-së kjo dëshmi do të kerkohet vetëm për OE/ofruesin e shërbimeve i cili propozohet për dhënie të kontratës).
4. Ofruesi i shërbimeve duhet që të ofrojë dëshmi se ka përvojë në fushën e eficiencës së energjisë, apo burimeve të ripërtëritshme të energjisë apo klimën – p.sh. Referenca për ofrimin e shërbimeve në fushën e eficiencës të energjisë apo burimeve të ripërtëritshme të energjisë, menaxhimit komunal të energjisë, hartimin e planeve komunale për eficiencë të energjisë / planeve komunale të veprimit për eficiencë të energjisë apo planet komunale të veprimit për energji të qëndrueshme (min. 3 referenca për punë të realizuara të kësaj natyre në 5 vitet e fundit në Kosovë apo rajon).
5. Ofruesi I shërbimeve duhet të ofrojë dëshmi për staf të kualifikuar dhe të sigurojë dëshmi për ekspertët/inxhinierët e angazhuar:
  - Të sigurojë CV-në e të paktën 2 inxhinierëve me përvojë të dëshmuar në fushën e eficiencës e energjisë (EE), apo burimeve të ripërtëritshme të energjisë ose klimën me përvojë minimale 3 vjet, me arsim përkatës: të paktën master ose diplomë ekuivalente në fushat inxhinierike (nga njëra nga këto fusha: arkitekturë, ndërtimtari, elektroteknike, inxhinieri mekanike). Referencat i bashkangjiten CV-së. (Shënim: përvoja përkatëse do të konsiderohet referenca për zhvillimin e politikave të EE apo klimën, planifikimet lokale/kombëtare për EE, projektet e zbatimit të masave të EE, etj.)

- CV e të paktën 4 inxhinierëve, me arsim përkatës me diplomë bachelor në fushat inxhinierike (nga njëra nga këto fusha: arkitekturë, ndërtimtari, elektroteknike, inxhinieri mekanike) me 2 vjet përvojë, ose diplomë master me së paku 1 vjet përvojë në eficencë e energjisë, apo burimet e ripërtëritshme të energjisë ose klimën. Referencat i bashkangjiten CV-së. (Shënim: përvoja përkatëse do të konsiderohet referenca teknike për mbikëqyrjen ose zbatimin e projekteve të zbatimit të masave të EE, hartimin e planeve/projekteve në fushën e EE, apo BRE – ve ose klimës).
- Një ekonomist, me min. 3 vjet përvojë në fushën profesionale që ka të bëjë me vlerësimin e projekteve investive, me arsim përkatës: të paktën master ose diplomë ekuivalente në ekonomi.
- Përvoja e dëshmuar në aplikimin e ndonjë vegle të teknologjisë informative (IT) për planifikim, menaxhimin, monitorimin ose raportimin e energjisë do të konsiderohet përparsi.
- Të sigurojë qarkullimin bankar për 3 vitet e fundit në vlerë se paku 40,000.00 € duke ofruar dëshmi nga banka ose Deklaratat tatimore vjetore të ATK-së.
- Dinamika e realizimit të shërbimit: Pas lidhjes së kontratës, në afat prej 15 ditësh kalendarike, ofruesi i shërbimeve do t'ia dorëzojë Komunës së Deçanit planin e punës për aktivitetet dhe afatin kohor për miratim për hartimin e PKVEK-se. Ofruesi duhet të ofrojë një plan dinamik detal për realizim të këtyre shërbimeve.

### **Vlerësimi i ofertave/aplikacioneve nga komisioni**

Komisioni Vlerësues i oferteseve për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) për Komunën e Deçanit varësish nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes lidhur me përbushjen e kritereve formale do të bëjë vlerësimin formal të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. Përbushja e kritereve formale nënkuption dorëzimin brenda afatit të dokumentacionit, të këruara përmes thirrjes. Komisioni do të vlerësoj edhe në rast të vetëm një ofertë të përgjegjshme.

Komisioni do të jetë në përbërje: 2 anëtar nga Komuna dhe një përfaqësues i GIZ-it në cilësinë e vëzhguesit/monitoruesit.

### **Financimi i aktiviteteve për hartimin e PKVEK-se për Komunën e Deçanit**


- Komuna e Deçanit i bën thirrje gjithë palëve të interesuara (ofrues të shërbimeve), fushëveprimi i të cilëve është i fokusuar në fushën e energjisë dhe klimës që të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve lidhur me hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) për Komunën e Deçanit
- Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 38.000,00 €
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është 10 ditë kalendarike pune nga data e publikimit nga data **05.04.2022** dhe përfundon me **19.04.2022** në ora **15:00**.

- Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe të mbyllura (të vulosura) në objektin e Komunës së Deçanit – kati II zyra nr.26

Vërejtje: Afatet kohore duhet të harmonizohen me LPP.

### **Kohëzgjatja e projektit dhe e drejta e aplikimit në thirrjen publike për hartimin e PKVEK-së për Komunën e Deçanit**

- Periudha e zbatimit të kontratës është 6 muaj ( shënim: Kontrata duhet të përfundojë në Nëntor 2022)
- Të drejtë aplikimi kanë ofrues të shërbimeve që plotësojnë kriteret e lartpërmendura dhe që dëshmojnë se fushëveprimi i tyre është i fokusuar në fushën e energjisë dhe klimës.
- Dokumentet e kompletuara duhet te dërgohen ne formën elektronike ne e-prokurim.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve /ofertave, vlerësimit të aplikacioneve/ofertave, kontraktimi, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi I dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë konform LPP-së.





Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

## **Model i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK)**

**2022 - 2030**

**MODEL DRAFT**

Shkurt 2022

## **Deklarim:**

Ky dokument është mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe zbatuar përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Energji.

Hartimi i këtij dokumenti është realizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) falë bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me grupin punues në kuadër të AKK-së.

Pikëpamjet e hartueseve të këtij dokumenti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

## **Informatë shtesë:**

Ky Model i Planit pasqyron versionin e zgjeruar të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEK) duke integruar elementet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe klimës. Modeli i planit është zhvilluar në kuadër të pilot projektit për mbështetje të AKK-së dhe forma finale duhet te miratohet pas aprovimit te Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK).

Modeli i këtij plani është krahasuar dhe zhvilluar në përputhje me Modelin e PKEK-së të ofruar nga Komuniteti i Energjisë dhe përmban të gjitha elementet e PKEK-së që e afektojnë/kanë ndikim në nivelin lokal.

Plani mbulon periudhën deri në vitin 2030 ndërsa aneksi: Plani i veprimit për zbatim duhet të mbulojë periudhën 3 vjeçare. Rishikimi i planit mund të bëhet pas kalimit të periudhës 3 vjeçare me qëllim të përditësimit të të dhënave apo vendosjen e masave apo politikave te reja lokale.

## PËRMBAJTJA

Tabelat .....	6
Figurat .....	8
Shkurtesat.....	9
1. Hyrje.....	10
1.1. Kontekstl .....	10
1.1.1. Objektivi i Planit komunal të veprimit për energji dhe klimë - PKVEK .....	10
1.1.2. Korniza ligjore dhe politikat.....	10
1.1.3. Aktivitetet dhe procesi përgatitor.....	10
1.1.4. Zhvillimi i Planit Komunal të Veprimit për ENergji dhe Klimë - PKVEK - .....	11
1.1.5. Zbatimi i PKVEK dhe përfitimet e pritshme.....	11
1.1.6. Miratimi si dokument zbatues .....	11
1.1.7. Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit dhe raportimi.....	11
2. Përbledhje e plotë.....	12
3. Informacioni bazë për komunën.....	12
3.1. Pozicioni dhe topografia .....	12
3.2. klima Lokale .....	12
3.3. Popullsia dhe vendbanimet .....	13
3.4. Struktura administrative lokale dhe organizative për zbatimin e Planit të energjisë dhe të klimës	13
3.5. Treguesit ekonomikë dhe finansiarë .....	14
3.6. Relevanca me politikat lokale, kombëtare dhe të tjera, përfshirja e autoriteteve lokale.....	14
3.7. Përvoja në zbatimin e Masave të EFIÇIENCës së enegjisë .....	15
3.7.1. Kapaciteti për të zbatuar projekte .....	16
4. Treguesit e energjisë për komunë (furnizimi dhe prodhimi i energjisë në komunë) ....	17
4.1. Furnizimi me energji .....	17
4.1.1. Energjia Elektrike.....	17
4.1.2. Lëndët djegese fosile .....	18
4.1.3. Biomasa.....	19
4.2. Gjenerimi i energjisë .....	20
4.2.1. Nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (HEC, PV diellore, termike diellore, pompë termike, erë, gjeotermale).....	20
4.2.2. Nga ngrohja qendrore.....	21
4.2.3. Të tjera (Ngrohje dhe energji e kombinuar, nxehësi e tepërt, absorbim, ...).....	21

4.3.	Prodhimi i energjisë sipas sektorëve .....	21
4.3.1.	Prodhimi i energjisë në sektorin e ndërtesave (ndërtesa private/rezidenciale, Komerciale, ndërtesa publike).....	21
4.3.2.	Prodhimi i energjisë në sektorë të tjerë .....	22
5.	Analiza e konsumit të energjisë sipas sektorëve .....	23
5.1.	Konsumi i energjisë në ndërtesa.....	23
5.1.1.	Konsumi i energjisë në ndërtesat e banimit .....	24
5.1.2.	Konsumi i energjisë në ndërtesa komerciale/tregtare dhe terciare.....	24
5.1.3.	Konsumi i energjisë në ndertesat në pronësi komunale .....	24
5.1.4.	Konsumi i energjisë në shërbimet publike.....	27
5.2.	Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë.....	28
5.3.	Konsumi i energjisë në sektorin e transportit.....	29
5.3.1.	Flota e Automjeteve komunale.....	29
5.3.2.	Transporti publik (nëse komuna ka kompani publike).....	30
5.3.3.	Automjete private dhe komerciale.....	31
5.4.	Konsumi i Energjisë në ndriçimin publik.....	32
6.	Objektivat dhe Targetet lokale.....	32
6.1.	Reduktimet e gazrave serrë .....	33
6.2.	Energjia e ripërtëritshme .....	33
6.3.	Efiçiencia e energjisë .....	33
6.4.	Varfëria energjetike .....	34
7.	Analizat e Emetimeve të gazrave serrë.....	35
7.1.	Inventari referencial i CO <sub>2</sub> .....	35
7.2.	Inventari i skenarit 'biznes i rëndom' (BSR) të CO <sub>2</sub> -2022-2030.....	38
8.	Politikat dhe masat për përmirësimin e Efiçiencës në energji, BRE dhe emetimit të GS40	
8.1.	Politikat dhe masat lokale.....	40
8.1.1.	Masat e efiçiencës së energjisë .....	40
8.1.2.	Masat e Burimeve të ripërtëritshme të energjise (BRE) .....	53
8.1.3.	Masat ndërsektoriale – ngritja e ndërgjegjësimit, informacioni dhe ngritja e kapaciteteve .....	59
8.1.4.	Masat e reduktimit të emetimit të gazrave serrë.....	60
8.1.5.	Reduktim total i gazrave serrë.....	61
9.	Plani i veprimit .....	64
9.1.	Zbatimi i masave të Politikës Vendore, Promovimi dhe ngritja e vetëdijes .....	64
9.2.	Zbatimi i masave në sektorin publik .....	65

9.3.	Zbatimi i masave në sektorin e sherbimeve publike .....	67
9.4.	Zbatimi i masave në sektorin komersial .....	68
9.5.	Zbatimi i masave në bujqësi .....	69
9.6.	Zbatimi i masave në transport.....	70
9.6.1.	Automjetet komunale .....	70
9.6.2.	transporti publik.....	71
9.6.3.	Automjetet private dhe tregtare .....	73
10.	Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e PKVEK/Planit të Veprimit.....	74
10.1.	Menaxhimi Komunal i energjisë (mund të përdoret nga skema e menaxhimit të energjisë, e përgatitur nga GIZ) .....	74
10.2.	Koordinimi .....	75
10.3.	Raportimi .....	75
10.1.3.	Monitorimi dhe raportimi i brendshëm.....	78
10.1.4.	Raportimi te qeveria qendrore (AKEE)- (mvp- software) .....	78
11.	Modeli dhe burimet e financimit të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë .....	79
11.1.	Financimi me Buxhetin Komunal .....	79
11.2.	Financimi nga Buxheti i Qeverisë Qendrore .....	79
11.3.	Financimi nga donatorët.....	79
11.4.	Financimi nga fondet e BE-se.....	80
12.	Përbyllje.....	80
13.	Referenca.....	80
14.	Shtojcat.....	81
14.1.	Shtojca 1 .....	81

## TABELAT

Tab. 3-1 Të dhënat gjeografike dhe demografike të komunës.....	13
Tab. 3-2 Organogrami i komunës.....	14
Tab. 3-3 Të dhënat e ndarjes së buxhetit të komunës .....	14
Tab. 3-4 Investimi total në masat e eficiencës të energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë .....	16
Tab. 4-1 Mesatarja e energjisë së furnizuar për tre vitet e fundit.....	17
Tab. 4-2 Energjia mesatare e furnizuar për tre vitet e fundit për lëndët djegëse fosile .....	18
Tab. 4-3 Energjia mesatare e furnizuar për tre vitet e fundit për biomasë .....	19
Tab. 4-4 Prodhimi total i energjisë nga BRE .....	21
Tab. 4-5 Prodhimi total i energjisë në sektorin e ndërtesave.....	21
Tab. 4-6 Prodhimi total i energjisë në sektorë të tjerë.....	22
Tab. 5-1 Konsumi total i energjisë.....	23
Tab. 5-2 Konsumi total i energjisë në sektorin e ndërtesave .....	23
Tab. 5-3 Konsumi total i energjisë në ndërtesat në pronësi te komunës .....	24
Tab. 5-4 Konsumi total i energjisë në ndërtesat e administratës .....	25
Tab. 5-5 Konsumi total i energjisë në ndërtesat e arsimit.....	25
Tab. 5-6 Konsumi total i energjisë në ndërtesat e kujdesit shëndetësor .....	26
Tab. 5-7 Konsumi total i energjisë në ndërtesat kulturore dhe sportive.....	26
Tab. 5-8 Konsumi total i energjisë në shërbimet publike .....	27
Tab. 5-9 Konsumi total i energjisë në sektorin e furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza .....	28
Tab. 5-10 Konsumi total i energjisë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.....	28
Tab. 5-11 Konsumi total i energjisë në sektorin e bujqësisë .....	29
Tab. 5-12 Konsumi total i energjisë në sektorin e transportit .....	29
Tab. 5-13 Konsumi total i energjisë për flotën komunale .....	30
Tab. 5-14 Konsumi total i energjisë në transportin publik - autobusët .....	30
Tab. 5-15 Konsumi total i energjisë në transportin publik - taksi .....	30
Tab. 5-16 Konsumi total i energjisë në transportin publik .....	31
Tab. 5-17 Konsumi total i energjisë në transportin privat dhe komercial .....	31
Tab. 7-1 Faktorët e emetimit të CO <sub>2</sub> dhe faktorët e energjisë primare .....	35
Tab. 7-2 Emetimi total i CO <sub>2</sub> .....	36
Tab. 7-3 Emetimi i CO <sub>2</sub> në ndriçimin publik .....	38
Tab. 7-4 Emetimi total i CO <sub>2</sub> për skenarin bazë (biznes si zakonisht). .....	38
Tab. 7-5 Konsumi total i parashikuar dhe emetimi i CO <sub>2</sub> për periudhën 2030 .....	39
Tab. 8-1 Masat e eficiencës së energjisë në sektorin rezidencial .....	41
Tab. 8-2 Masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat administrative.....	42
Tab. 8-3 Masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat arsimore.....	43
Tab. 8-4 Masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat e kujdesit shëndetësor.....	44
Tab. 8-5 Masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat e kulturore dhe sportive .....	45

Tab. 8-6 Masat e eficiencës së energjisë në ndërtesat komerciale dhe te sherbimeve .....	46
Tab. 8-7 Masat e eficiencës së energjisë në sistemin e ndriçimit publik .....	47
Tab. 8-8 Masat e eficiencës së energjisë në sektorin e furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza .....	48
Tab. 8-9 Masat e eficiencës së energjisë në sektorin e grumbullimit/menaxhimit të mbetjeve .....	49
Tab. 8-10 Masat e eficiencës së energjisë në sektorin e bujqësisë .....	49
Tab. 8-11 Masat e eficiencës së energjisë në sektorin e transportit .....	51
Tab. 8-12 Masat e eficiencës së energjisë në transportin publik .....	52
Tab. 8-13 Masat e eficiencës së energjisë në automjetet private dhe komerciale .....	53
Tab. 8-14 Masat e BRE-ve në sektorin rezidencial .....	54
Tab. 8-15 Masat e BRE në sektorin publik .....	55
Tab. 8-16 Masat e BRE në sektorin e sherbimeve .....	56
Tab. 8-17 Masat e BRE në sektorin komercial .....	57
Tab. 8-18 Masat e BRE në sektorin e bujqësisë .....	58
Tab. 8-19 Masat e BRE në sektorin e transportit .....	58
Tab. 8-20 Masat ndërsektoriale .....	59
Tab. 8-21 Masat per reduktimin e gazrave serre .....	60
Tab. 8-22 Reduktimi i CO <sub>2</sub> nga Politikat dhe Masat .....	61
Tab. 8-23 Reduktimet totale të emetimeve të GS në sektorin e ndërtesave .....	61
Tab. 8-24 Reduktimet totale të emetimeve të GS në sektorin e transportit .....	62
Tab. 8-25 Reduktimet totale të emetimeve të GS në sektorin e bujqësisë .....	63
Tab. 8-26 Përbledhje e reduktimeve totale të emetimeve të GS nga masat jo EE, masat e EE dhe masat e BRE .....	64
Tab. 9-1 Plani i veprimit për zbatimin e masave për EE .....	64
Tab. 9-2 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE-ve .....	65
Tab. 9-3 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS .....	65
Tab. 9-4 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin publik .....	65
Tab. 9-5 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin publik .....	66
Tab. 9-6 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin publik .....	66
Tab. 9-7 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin e shërbimeve publike .....	67
Tab. 9-8 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin e shërbimeve publike .....	67
Tab. 9-9 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin e shërbimeve publike .....	67
Tab. 9-10 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin komercial .....	68
Tab. 9-11 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin komercial .....	68
Tab. 9-12 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin komercial .....	69
Tab. 9-13 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin e bujqësise .....	69
Tab. 9-14 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin e bujqësise .....	69
Tab. 9-15 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin e bujqësise .....	70
Tab. 9-16 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin e transportit .....	70
Tab. 9-17 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin e transportit .....	71
Tab. 9-18 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin e transportit .....	71
Tab. 9-19 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në sektorin e transportit publik .....	71
Tab. 9-20 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në sektorin e transportit publik .....	72

Tab. 9-21 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në sektorin e transportit publik .....	72
Tab. 9-22 Plani i veprimit për zbatimin e masave të EE në automjete private dhe komerciale.....	73
Tab. 9-23 Plani i veprimit për zbatimin e masave të BRE në automjete private dhe komerciale ....	73
Tab. 9-24 Plani i veprimit për zbatimin e masave të reduktimit te GS në automjete private dhe komerciale .....	73
Tab. 10-1 Kompleksiteti në procesin e raportimit.....	75

## **FIGURAT**

Fig. 3-1 Cikli i zbatimit të masave të EE .....	16
Fig. 5-1 Konsumi i karburantit të flotës komunale .....	32
Fig. 7-1 Shpërndarja e burimieve të energjisë.....	37
Fig. 7-2 Emetimi i CO <sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave .....	37
Fig. 7-3 Konsumi i karburantit në sektorin e transportit .....	38

## SHKURTESAT

AKK	Asociacioni I Komunave të Kosovës
BIZ	Biznes i zakonshëm
IBSH	Inventari bazë i shkarkimeve
BoQ	Paramasa
SMN	Sistemi I Menaxhimit te Ndërtesës
CoM	Konventa e Kryetarëve
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EE	Efiçiencia e Energjisë
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energi
BE	Bashkimi Evropian
KSHE	Kompanite e Sherbimit te Energjise
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
GHG	Greenhouse Gases – Gazrat serrë
IFI	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IAP	Instrumentet për Asistencën e Para-Aderimit
MBK	Norma e Brendshme e Kthimit
AKEE	Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë
FKEE	Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
BGJR	Banka Gjermane për Rindërtim
PKEK	Plani Komunal i Energjisë dhe Klimës
PKVEE	Plani Komunal i Veprimit për Efiçencë dhe Energi
MISH	Monitorimi i inventarit të shkarkimeve
MMPH	Ministria e Mjedosit dhe Planifikimit Hapësinor
MFK	Millennium Foundation Kosova
PMV	Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
PV	Panelë fotovoltaike
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
ER	Energjia e Ripërtëritshme
EJL	Evropa Juglindore
PVEQK	Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën
HV	Hidrocentral i Vogël
PTHK	Periudha e thjeshtë e kthimit
ATSHI	Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni
VTR	Valvula termostatike të radiatorit
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
NEZ	Ndërtesa me konsum afér zero energji
KIBP	Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor
FDEQBP	Financimi i drejtpërdrejtë i Energjisë së Qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor

## 1. HYRJE

### 1.1. KONTEKSTI

#### 1.1.1. OBJEKTIVI I PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR ENERGJI DHE KLIMË - PKVEK

Përshkrim i shkurtër i objektivave të PKVEK lidhur me zhvillimin e sektorit ekonomik dhe energjetik të komunës.

Përshkrimi i përfitimeve kombëtare në përgatitjen e PKVEK si dhe i përfitimeve të komunës.

Vizion i shkurtër i komunës në zhvillimin e sektorit të energjisë, gjenerimin e BRE-ve dhe zvogëlimin e emetimeve që kanë ndikim të rëndësishëm.

#### 1.1.2. KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKAT

Përshkrim i shkurtër i kuadrit ligjor për planifikimin, miratimin dhe zbatimin e politikave të energjisë që i përkasin detyrimeve të nivelit komunal

Rregullat dhe rregulloret përkatëse si dhe ligjet që lidhen me energjinë, eficiencën e energjisë, gjenerimin e BRE-ve dhe reduktimin e emetimit të CO<sub>2</sub>

Listoni gjithë legjislacionin kombëtar (ligjet, rregullat, rregulloret, udhëzimet administrative...) lidhur me energjinë, BRE-të dhe reduktimin e emetimeve që kanë ndikim në detyrimet komunale (Vini re: jo doemos detyrim për PKVEK).

Listoni të gjithë legjislacionin e BE-së (ligjet, rregullat, rregulloret, udhëzimet administrative,...) që lidhen me energjinë, BRE dhe reduktimin e emetimeve.

Listoni të gjitha dokumentet përkatëse të miratuara në lidhje me energjinë, BRE dhe reduktimin e emetimeve.

#### 1.1.3. AKTIVITETET DHE PROCESI PËRGATITOR

Përshkruani detyrat dhe detyrimet e komunës për përgatitjen e PKVEK, siç janë:

- Integrimi i objektivave dhe masave të PKVEK në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të Komunës;
- Emërimi i stafit profesional për planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë, aplikimin e masave të eficiencës së energjisë, aplikimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme dhe lëndëve djegëse ekologjikisht të pranueshme;
- Vlerësimi i mjeteve financiare për zbatimin e PKVEK;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të kursimit të energjisë dhe kursimeve financiare, si dhe monitorimi i reduktimit të gazrave serrë;
- Mbështetja për zbatimin e masave të parashikuara në të gjithë periudhën e parashikuar të zbatimit të PKVEK, deri në vitin 2030;
- Monitorimi dhe raportimi mbi dinamikën e zbatimit të PKVEK deri në vitin 2030;
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me shkallën e zbatimit të PKVEK;
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve kryesorë dhe qytetarëve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PKVEK

#### **1.1.4. ZHVILLIMI I PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR ENERGJI DHE KLIMË - PKVEK -**

Përshkruani metodologjinë e zhvillimit të PKVEK, strukturën komunale dhe vitin referues. Përshkruani se si është analizuar dhe vendosur inventarizimi i CO<sub>2</sub>. Viti referent do të krijohet bazuar në disponueshmërinë e datës që komuna është në gjendje të ofrojë, (rekomandimi nga BE është me marrë vitin 1990, në rast të mungesës së të dhënave, atëherë, viti referent mund të krijohet vetëm për vitin që ka të dhëna të disponueshme, duke shkuar prapa nga viti aktual).

Përshkruani/listoni cilët sektorë janë marrë për analizimin e konsumit të energjisë (p.sh. ndërtesa publike, transporti, ndriçimi publik i rrugëve, sektori komercial, sektori i amvisërisë....etj).

#### **1.1.5. ZBATIMI I PKVEK DHE PËRFITIMET E PRITSHME**

Përshkruani përfitimet e pritshme nga zbatimi i PKVEK; (për orientim, lista e mundshme e përfitimeve jepet më poshtë):

- Përmirësimi i EE në proceset e prodhimit dhe aplikimi i teknologjive të BRE që synojnë zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis, rritjen e produktivitetit dhe pjesëmarrjen e BRE në konsumin e përgjithshëm të energjisë në territorin komunal.
- Planifikimi më i mirë dhe optimizimi i shërbimit; furnizimi me ujë, grumbullimi i mbeturinave dhe ndriçimi publik i rrugëve.
- Kursimi i energjisë dhe rritja e investimeve në sektorin e energjisë përmes térheqjes së investimeve të ndryshme të IFI-së si dhe atyre private.
- Rritja e buxhetit komunal për investime kapitale, ose investime sociale, duke zvogëluar konsumin e energjisë përmes zbatimit të masave të kursimit të energjisë.
- Përmbushja e detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret kombëtare, përfshirë ato që dalin nga PKEK dhe PKVBR (Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripertrishme të Energjisë).

#### **1.1.6. MIRATIMI SI DOKUMENT ZBATUES**

Përshkruani procesin dhe procedurat për miratimin e PKVEK nga autoritetet komunale, si element kyç për ndarjen dhe zbatimin e buxhetit. Është praktikë dhe obligim i përgjithshëm që çdo plan zhvillimor komunal që ndikon në drejtori ose palë të ndryshme të interesit të miratohet nga kuvendi komunal.

Është e rekomandueshme që aktorët kryesorë ekzekutivë brenda administratës komunale të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e hartimit/zhvillimit të PKVEK, dhe në fazën e fundit, për zbatimin dhe monitorimin. Për më tej, është shumë e rëndësishme të krijohet një grup pune si organ këshillues që do ta drejtojë procesin e hartimit të planit, si dhe gjatë procesit të miratimit. Pasi të miratohet plani, do të caktohet adresa e qartë për zbatimin, monitorimin dhe raportimin.

#### **1.1.7. MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT DHE RAPORTIMI**

Përshkruani se si organizohet procesi i monitorimit dhe i verifikimit, cilat mjete përdoren dhe si mblidhen të dhënat e monitorimit. Agjencioni i Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka miratuar platformën për monitorim dhe verifikim (MVP) që do të përdoret për monitorimin e zbatimit të masave të EE dhe BRE në Nivel lokal. Autoriteti komunal duhet të ketë personel të trajnuar për të

vepruar me mjetet që të jetë në gjendje të raportojë rregullisht në AKEE. Periudha e raportimit rregullohet me ligjin për eficiencën e energjisë (**LIGJI NR. 06/L-079 PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË**)

Menaxheri komunal i energjisë është zakonisht personi përgjegjës për një detyrë të tillë, dhe i raporton Agjencionit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE-së).

Për monitorimin dhe verifikimin e reduktimit të CO<sub>2</sub>, metodologja duhet të jetë e njëjtë me atë që përdoret për përcaktimin e Inventarit Referent të Emetimeve të CO<sub>2</sub> për vitin bazë. Vetëm përdorimi i të njëjtës metodologji, bën të mundshëm kahasimin dhe i përgjigjet pyetjes nëse janë duke u përbushur objektivat e reduktimit të emetimeve të përcaktuara për CO<sub>2</sub>.

## 2. PËRMBLEDHJE E PLOTË

Përkruani këtu një përbledhje të shkurtër për thelbin/esencën dhe gjetjen kryesore të planit. Përbledhja ekzekutive duhet t'u përgjigjet pyetjeve shkurtimisht.

- Shkurtimisht, për çka është plani?
- Pse është i rëndësishëm? [ose] Pse është ndërmarrë?
- Cilat janë gjetjet ose rezultatet kryesore?
- Çfarë duhet bërë më shumë? [ose] Si do të zbatohen këto gjetje?
- Cili është hapi tjetër?

**“Plani Komunal i Veprimit për Energi dhe Klimë”** paraqet gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga analizat e situatave aktuale dhe zbatimin e vlerësimit ndërsektorial të energjisë në nivel lokal, për sektorët përkatës: sektorin e ndërtimesave, sektorin e shërbimeve, sektorin e transportit, ndriçimin publik, sektorin industrial dhe sektorin e bujqësisë.

Qëllimi është vlerësimi dhe analizimi i konsumit të energjisë dhe gjenerimi i energjisë në të gjithë sektorët, performanca e tyre në përdorimin e energjisë dhe masat për përmirësimin e performancës së energjisë, arritjen e kursimeve të energjisë dhe reduktimin e emetimit të gazrave serrë.

## 3. INFORMACIONI BAZË PËR KOMUNËN

Jepni një përkrim të shkurtë mbi zhvillimin e ekonomisë lokale, elementet sociale dhe kulturore që e karakterizojnë Komunën. Buxheti dhe të hyrat komunale.

### 3.1. POZICIONI DHE TOPOGRAFIA

Përkruani informacionin bazë për Komunën, pozicionin territorial/gjeografik dhe si lidhet me komunat fqinje. Vendndodhja e tij, lartësia xxx – xxx metra mbi nivelin e detit. Cilat janë elementet kryesore tipike që karakterizojnë Komunën?

### 3.2. KLIMA LOKALE

Përkruani gjendjen klimatike lokale (shembull: - Klima në Komunën "X" është kontinentale, me verë të nxehëtë dhe dimër të ftohtë. Dimrat mund të janë të ftohtë deri në -5°C si mesatare, ndërsa verat janë të buta, me mesatare prej 24°C. Temperatura më e ftohtë e regjistruar në tre

vjetët e fundit ishte **-22°C** ndërsa më e nxeha e regjistruar gjatë verës ishte **40°C** Ngriçat mbulojnë qytetin nga mesi i tetorit deri në mes të prillit, duke sjellë mot shumë të ftohtë midis dhjetorit dhe shkurtit. Periudha e ngrohjes fillon nga 15 tetori deri më 15 prill, ndërsa nevoja për ftohje parashihet prej fundit të qershorit deri në fillim të shtatorit.

### 3.3. POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Përshkruani numrin e banorëve XXX Mijëra banorë - ku rreth X% e popullsisë jeton në qytet dhe X% në vendbanimet periferike. Territori i Komunës është mbi xxx km<sup>2</sup> dhe numëron X vendbanime (fshatra) periferike. Konsumi i energjisë mund të paraqitet si konsum i energjisë për kokë banori.

A po zgjerohet qyteti vitet e fundit? (me "aneksimin" e një vendbanimi periferik të afërt), a rritet popullsia vitet e fundit për shkak të migrimit, zgjerimit të zonave të qytetit dhe rritjes natyrore të popullsisë, etj...., Përshkruani përbërjen etnike të popullsisë komunale. Përdorni regjistrimin e fundit!

Tabela më poshtë paraqet të dhëna të rëndësishme gjeografike dhe demografike për komunën:


Tab. 3-1 Të dhënat gjeografike dhe demografike të komunës

Komuna	[Emri I Komunës]
Adresa	
Regioni	
Kodi Postar	
Ueb-faqja	<a href="http://www.kk.rks.gov.net/[nemri I komunës]">www.kk.rks.gov.net/[nemri I komunës]</a>
Sipërfaqja totale	0,000.00 m <sup>2</sup>
Numri i fshatrave/banimeve	00/00
Sipërfaqja e zonës urbane	0,000.00 ha
Numri i familjeve	0,000.00
Popullsia	0,000.00 qytetarë
Dendësia	000 qytetarë/km <sup>2</sup>
Numri mesatar i anëtarëve të familjes	0.00/anetar/familje
Toke bujqësore	0,000.00 ha
Pyll	0,000.00 ha
Klima	Kontinentale
Sezoni i ngrohjes	185 ditë

### 3.4. STRUKTURA ADMINISTRATIVE LOKALE DHE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E PLANIT TË ENERGJISË DHE TË KLIMËS

Përshkruani strukturën administrative dhe organizative të Komunës, dhe mënyrën se si janë vendosë strukturat komunale për zbatimin e planit komunal. (shembull-organogrami komunal)

Tab. 3-2 Organogrami i komunës



### 3.5. TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË

Përshkruani aktivitetet kryesore ekonomike në territorin e Komunës; dhe (në rast të informacionit të disponueshëm) kontributin në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB). Cilët janë sektorët kryesorë ekonomikë që kontribuojnë në ekonominë lokale: prodhim, ndërtim, shërbim, tregti, industri (përfshirë industrinë ushqimore), transport, etj. Cili është statusi i punësimit, numri i vlerësuar XXX i të papunëve, duke treguar normë papunësie në xx%, rënje/rritje me xx% gjatë tri viteve të fundit? Përshkruani nëse ka një atraksion turistik ose kulturor që tërheq turistë për shkak të elementeve të veta historike ose kulturore në territorin e Komunës.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna të rëndësishme për buxhetin e komunës:

Tab. 3-3 Të dhënat e ndarjes së buxhetit të komunës

[Emri i Komunes]	Viti Fiskal
Buxheti total	€ 00,000,000.00
Fatura totale e energjisë elektrike	€ 00,000,000.00
Fatura totale e ngrohjes	€ 00,000,000.00
Fatura e energjisë elektrike për ndriçimin publik	€ 00,000,000.00
Fatura e karburantit për ndërtesat në pronësi të komunës	€ 00,000,000.00
Investimi total në masat e EE	€ 00,000,000.00
Investime direkte nga buxheti i komunës	€ 00,000,000.00
Investime direkte nga buxheti qendror dhe grantet	€ 00,000,000.00

### 3.6. RELEVANCA ME POLITIKAT LOKALE, KOMBËTARE DHE TË TJERA, PËRFSHIRJA E AUTORITETEVE LOKALE

Plani do të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare, veçanërisht me Ligjin për eficiencën e energjisë. Autoritetet vendore dhe kombëtare do të marrin pjesë në shkëmbimin konsultativ për të diskutuar procesin e hartimit. Ato seminare do të shpjegojnë procesin dhe llojin e informacionit që përpunohet. Kur të përfundojë drafti i PKVEK-ës, procesi i konsultimit do të ndiqet më intensivisht me AKEE-në për miratim përfundimtar para se t'i paraqitet kuvendit komunal për miratim.

Lista e ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve në fuqi që ndikojnë në këtë proces janë:

- Ligji Nr. 05 / L-081 për Energjinë
- Ligji Nr. 05 / L-085 për Energjinë Elektrike
- Ligji Nr. 05 / L-084 për Rregulatorin e Energjisë
- Ligji Nr. 06 / L-079 për Eficiencën e Energjisë
- Ligji Nr. 05 / L-101 për Performancën Energjetike të Ndërtesës
- Ligji Nr. 03 / L-116 për Ngrohjen Qendrore
- Ligji Nr. 04 / L-110 për Ndërtim
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2012 për Promovimin e Eficiencës në Shfrytëzim të Energjisë dhe Shërbimeve të Energjisë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për Auditimet e Energjisë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2012 për Etiketimin e Produkteve të Ndërlidhura me Energjinë
- Rregullorja e MMPH-së Nr. 01/2018 për Inspektimin e Sistemit të Ngrohjes dhe Kondicionimit
- Rregullorja MMPH Nr. 02/2018 për Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes për Performancën e Integruar të Energjisë së Ndërtesave
- Rregullorja e MMPH Nr. 03/2018 e Procedurave për Çertifikimin e Performancës Energjetike të Ndërtesës
- Rregullorja MMPH Nr. 04/2018 Kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave
- Rregulli për Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtirishme të Energjisë

### 3.7. PËRVOJA NË ZBATIMIN E MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENEGJISË

Zbatimi i suksesshëm i masave komunale të EE kërkon pronësi dhe një pjesë të madhe të angazhimit nga palët e interesuara komunale. Përshkruani përvojën e mëparshme në zbatimin e masave të EE: Cikli i zbatimit - menaxhimi i procesit, projektimi, mbikëqyrja dhe monitorimi, përfshirë strukturën e financimit, etj.

Duhet të përshkruhet një analizë e strukturuar e sektorit për t'i përcaktuar sfidat dhe masat dhe për të kuptuar bashkë përfitimet e lidhura. Është me rëndësi të koordinohen edhe politikat vendore/lokale në mënyrë që të adresohen barrierat në të gjithë sektorët.




Fig. 3-1 Cikli i zbatimit të masave të EE

### 3.7.1. KAPACITETI PËR TË ZBATUAR PROJEKTE

Përshkruani kapacitetet komunale për zbatimin e planit. Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe kriimi i një pike qëndrore me fokus në EE dhe BRE në Komunë, është kritike për çdo zbatim të suksesshëm të një programi të PKVEK-së. Kjo mund të bëhet duke krijuar një divizion komunal të dedikuar për energjinë brenda departamentit/administratës komunale.

Investimi total në masat e eficiencës të energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë në nivel komune mund të paraqiten në formatin e tabelës më poshtë.

Tab. 3-4 Investimi total në masat e eficiencës të energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë

Masat e Eficiencës së Energjisë dhe BRE	Kostoja totale e investimit ndër vite (€)		
	2019	2020	2021
Instalimi i sistemit eficientë të ngrohjes qendrore			
Ndërrimi i dritareve dhe izolimi i çatisë			
Ndërrimi i dyshemesë			
Ndërrimi i ndriçuesve			
Instalimi i SMN			
Instalimi i valvulave balancuese TRV			
Instalimi i kolektorëve diellorë			
Instalimi i fotovoltaikëve			
Instalimi i pompave termike			
Totali			

## 4. TREGUESIT E ENERGJISË PËR KOMUNË (FURNIZIMI DHE PRODHIMI I ENERGJISË NË KOMUNË)

### 4.1. FURNIZIMI ME ENERGJI

Përshkrim i shkurtër i furnizimit me energji në vend duke përfshirë energjinë elektrike, lëndët djegëse fosile dhe biomasën.

Sasia e përgjithshme aktuale e energjisë së furnizuar, si mesatare e tre viteve të fundit, nga të gjitha burimet e disponueshme të energjisë për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë. Vendosni tabelat dhe grafikët që paraqesin të gjitha furnizimet për të gjitha kategoritë përkatëse.

Tab. 4-1 Mesatarja e energjisë së furnizuar për tre vitet e fundit

Sektori/	Dru zjarri	Linjat(nëse përdoret)	Pelet	Naftë	Energji elektrike	Gaz	Të tjera
	m <sup>3</sup>	ton	ton	litër	MWh/a	m <sup>3</sup>	
Rezidencial							
Publik*							
Komercial/terciar							
Ndriçim publik							
Transporti							
Totali							

\*Ndërtesat publike përfshijnë administratën, shëndetësinë, kulturën, arsimin, dhe ndërtesat e shërbimeve

#### 4.1.1. ENERGJIA ELEKTRIKE

##### 4.1.1.1. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Përshkrimi i furnizimit me energji elektrike, pengesat dhe kapacitetet e kufizuara të prodhimit në nivel kombëtar, me fokus komunën.

Sasia e përgjithshme aktuale e energjisë elektrike të furnizuar, mesatarisht në tri vitet e fundit, për sektorin e ndërtesave, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë. Vendosni tabelat dhe grafikët që paraqesin të gjitha furnizimet për të gjitha kategoritë përkatëse.

#### **4.1.1.2. SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Përshkrimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, pengesat dhe kapacitetet e kufizuara investuese në nivel kombëtar, me fokus komunën. Përshkruani planet dhe projektet e zhvillimit të energjisë elektrike për komunën.

#### **4.1.2. LËNDËT DJEGESE FOSILE**

Prezantim i shkurtër i lëndëve djegëse fosile të përdorura në nivel komunal. Prezantoni, në tabelë ose grafikonë, sasinë e përgjithshme të të gjitha lëndëve djegëse të përdorura në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit. Në rast se nuk ka të dhëna të besueshme për sektor të caktuar, mund të bëhet një vlerësim ose modelim.

*Tab. 4-2 Energjia mesatare e furnizuari për tre vitet e fundit për lëndët djegëse fosile*

Sektori/	Naftë	Benzinë	Mazut	LPG	Linjt(nëse përdoret)	Të tjera
	litër	litër	ton	m <sup>3</sup>	ton	
Rezidencial						
Publik						
Komercial/terciar						
Transporti						
Totali						

*Shënim: Tabela mund të zgjerohet për më shumë burime energjie, në varësi të komunës dhe llojit të burimeve të energjisë që përdorin*

##### **4.1.2.1. NAFTË**

Përshkrim i shkurtër i naftës dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtim, transport dhe bujqësi).

Prezantoni, në tabelë ose grafikonë, sasinë e përgjithshme naftës të përdorur në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit.

##### **4.1.2.2. BENZINË**

Përshkrim i shkurtër i benzinës dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtim, transport dhe bujqësi).

Prezantoni, në tabelë ose grafikone, sasinë e përgjithshme të benzinës të përdorur në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit.

#### 4.1.2.3. MAZUT

Përshkrim i shkurtër i mazutit dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtim, transport dhe bujqësi).

Prezantoni, në tabela ose grafikonë, sasinë e përgjithshme të mazutit të përdorur në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit.

#### 4.1.2.4. LPG

Përshkrim i shkurtër i gazit te lëngshëm te naftës (LPG) dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtim, transport dhe bujqësi).

Prezantoni, në tabela ose grafikonë, sasinë e përgjithshme të LPG të përdorur në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit.

#### 4.1.2.5. THËNGJILL - LINJIT (VETËM NËSE ËSHTË I ZBATUESHËM OSE PËRDORET NË SEKTORIN PRIVAT/AMVISËRI)

Përshkrim i shkurtër i thëngjillit dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtim, transport dhe bujqësi).

Prezantoni, në tabela ose grafikonë, sasinë e përgjithshme të thëngjillit të përdorur në nivel komune për sektorin e ndërtesave, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit.

**Bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 06/74 të datës 06.11.2018, përdorimi i thëngjillit përgrohjen e institacioneve publike është i ndaluar.**

#### 4.1.3. BIOMASA

Përshkrim i shkurtër i kapacitetit të biomasës brenda nivelit komunal dhe konsumit të të gjithë biomasës dhe produkteve të saj të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtimi, transporti dhe bujqësia).

Prezantoni, në tabela ose grafikonë, sasinë e përgjithshme të të gjitha llojeve të biomasës të përdorura në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit. Gjithashtu prezantoni në tabelë vlerat kalorifike dhe vetitë fizike e kimike të të gjitha llojeve të biomasës.

*Tab. 4-3 Energjia mesatare e furnizuar për tre vitet e fundit për biomasë*

Sektori/	Dru zjarri	Pelet	Copëza druri	Të tjera
	m <sup>3</sup>	ton	ton	
Rezidencial				
Publik				
Komercial/terciar				
Transporti				

Totali				
--------	--	--	--	--

*Shënim: Tabela mund të zgjerohet për më shumë burime energjje, në varësi të komunës dhe llojit të burimeve të energjisë që përdorin*

#### 4.1.3.1. DRU ZJARRI

Përshkrim i shkurtër i të gjitha llojeve të druve të zjarrit të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtimi, transporti dhe bujqësia).

Prezantoni, në tabelën e sasitës së përgjithshme të druve të zjarrit të përdorura në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit. Gjithashtu prezantoni në tabelë vlera kalorifike dhe vetitë fizike dhe kimike të llojeve të ndryshme të druve të zjarrit të përdorur.

#### 4.1.3.2. PELET

Përshkrim i shkurtër i të gjitha llojeve të peletit/briketit të përdorura në komunë për të gjithë sektorët (ndërtimi, transporti dhe bujqësia).

Prezantoni, në tabelën e sasitës së përgjithshme të peletit/briketit të përdorura në nivel komune për sektorin e ndërtimit, sektorin e transportit dhe sektorin e bujqësisë, mesatarisht në tri vitet e fundit. Gjithashtu prezantoni në tabelë vlera kalorifike dhe vetitë fizike dhe kimike të llojeve të ndryshme të peletit/briketit të përdorur.

#### 4.1.3.3. TË TJERA

Nëse aplikohet në komunën përkatëse (p.sh. Ju lutemi përshkruani nëse përdorni dru, ose biomasë tjeter bujqësore si: misër, kashtë, bimë, mbeturina shtazore, rropulli dhe barëra shumëvjeçare)

### 4.2. GJENERIMI I ENERGJISË

Përshkrim i shkurtër i gjenerimit të energjisë në nivel komunal, duke përfshirë impiantet konvencionale dhe burimet e BRE-ve. Listoni termocentralet ose prodhuesit e energjisë që veprojnë në territorin e komunës.

#### 4.2.1. NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË (HEC, PV DIELLORE, TERMIKE DIELLORE, POMPË TERMIKE, ERË, GJEOTERMALE)

Përshkruani të gjitha burimet e BRE-ve në komunë, përfshirë gjeneruesit dhe konsumatorët komerciale dhe privatë.

Cila është pjesa e burimeve të BRE në kapacitet dhe gjenerim në komunën X. Të dhënat mund të merren nga pëlgimi i dhënë prej administratës komunale, leja e ndërtimit ose ZRRE.

Tab. 4-4 Prodhimi total i energjisë nga BRE

Sektori/	PV panele diellore	Kolektorë termik diellorë	Erë	Pompë termike	HEC i vogël	Gjeotermale	Të tjera
	MWh/a	MWh/a	MWh/a	MWh/a	MWh/a	MWh/a	MWh/a
Rezidencial							
Publik							
Komercial/terciar							
Ndriçim publik							
Transporti							
Totali							

#### 4.2.2. NGA NGROHJA QENDRORE

Nëse është e rëndësishme për komunën, përshkrimi i ngrohjes qendrore, gjenerimi dhe shpërndarja e nxehesisë, përfshirë llojin e burimit të energjisë të përdorur.

Prezantoni kapacitetin e instaluar, kapacitetin operacional dhe prodhimin e energjisë termike për ngrohjen qendrore.

#### 4.2.3. TË TJERA (NGROHJE DHE ENERGJI E KOMBINUAR, NXEHTËSI E TEPËRT, ABSORBIM, ...)

Vetëm nëse është e vlefshme në komunë.

#### 4.3. PRODHIMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

##### 4.3.1. PRODHIMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTESAVE (NDËRTESA PRIVATE/REZIDENCIALE, KOMERCIALE, NDËRTESA PUBLIKE)

Përshkruani të gjitha llojet e prodhimit të energjisë në sektorin e ndërtesave. Energjia aktuale e gjeneruar nga të gjitha llojet e gjeneratorëve në sektorin e ndërtesave, duke përfshirë energji elekrike, ujë të nxehë, ngrohje, etj. por pa u kufizuar në to.

P.sh. Në sektorin e ndërtesave në komunën X janë konsumatorë të instaluar, kryesisht impiante fotovoltaikë, kolektorë diellorë me ujë të nxehë dhe kaldaja për ngrohje.

Tab. 4-5 Prodhimi total i energjisë në sektorin e ndërtesave

Prodhimi i energjisë në sektorin e ndërtesave			
		Kapaciteti i instaluar	Energjia vjetore e gjeneruar

Prodhimi i energjisë në ndërtesat e banimit	Energji elektrike nga panelet fotovoltaikë		
	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		
Prodhimi i energjisë në ndërtesat publike	Energji elektrike nga panelet fotovoltaikë		
	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		

#### 4.3.2. PRODHIMI I ENRGJISË NË SEKTORË TË TJERË

Përshkruani prodhimin e energjisë në sektorë të tjerë. Paraqisni energjinë totale të gjeneruar nga të gjitha llojet e gjeneratorëve, duke përfshirë por pa u kufizuar në energjinë elektrike, ujë të ngrohtë, ngrohje, impiante fotovoltaikë, konsumatorë prodhues, erë, etj.

Tab. 4-6 Prodhimi total i energjisë në sektorë të tjerë

Prodhimi i energjisë në sektorët tjerë			
		Kapaciteti i instaluar	Energjia vjetore e gjeneruar
Prodhimi i energjisë në sektorin e ndërtesave komerciale/terciare	Energji Elektrike nga panelet fotovoltaikë		
	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		
Prodhimi i energjisë në shërbimet publike	Energji Elektrike nga panelet fotovoltaikë		
	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		
Prodhimi i energjisë në industri	Energji Elektrike nga panelet fotovoltaikë		
	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		
Prodhimi i energjisë në sektorin e bujqësisë	Energji Elektrike nga panelet fotovoltaikë		

	Ujë i nxeh të (kolektor termik diellor)		
	Kaldaja e ngrohjes		

## 5. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Përshkruani cilët sektorë mbulohen dhe ku janë marrë të dhënrat përkatëse për analizën e konsumit të energjisë:

- Sektori i ndërtesave (ndërtesat e banimit, shtëpi banimi ndërtesat në pronësi komunale, shërbimet, të tjera)
- Sektori i ndriçimit të rrugëve
- Sektori i transportit
- Bujqësor

Konsumi aktual total i energjisë për secilin sektor i shprehur në MWh në vit si një mesatare e tri viteve të fundit.

Tab. 5-1 Konsumi total i energjisë

Sektori	Nënsektori	Konsumi [MWh/a]
Ndërtesë	Publike	
	Private	
Transporti	Publik	
	Privat	
Ndriçimi publik		
Bujqësor		
Totali		

Sektorët përkatës komunalë duhet të përfshihen në fushat ku ata kontribuojnë dhe ndajnë përgjegjësi. Nëse motivimi fillestari është thjesht politik për nga natyra, kryetari i komunës ose kryesuesi i një komiteti mund të përcaktojë përgjegjësinë kryesore për drejtimin e procesit nga aspekti politik. Vendoja e përgjegjësisë administrative në një vend të vetëm është një avantazh, dhe mundësish me një person ose zyrë të vetme (Menaxheri i Energjisë ose Zyre e Energjisë), sepse kjo pritet t'i japë prioritet të lartë procesit të koordinimit. Megjithatë, përgjegjësia e përgjithshme për koordinimin e procesit duhet t'i caktohet kësaj zyre, por një koordinim dhe bashkëpunim i ngushtë me sektorë apo departamente të tjera është vendimtar për interesin e hartimit të planit.

Disa nga sfidat kryesore dhe gjendja ekzistuese për sektorët mund të renditen si më poshtë.

- Sektorët rezidencialë, komercialë dhe industrialë (mjedisi i ndërtuar) në komuna janë në masë të madhe të varur nga energjia elektrike për të përbushur nevojat e energjisë, me përdorim të lëndëve djegëse të lëngshme (naftë, GLN), qymyr dhe dru për ngrohje dhe gatim të brendshëm, dhe shumë pak energji diellore, termike për ngrohjen e ujit.

- Përpunimi industrial, prodhimi dhe agronomia janë gjithashtu shumë të varura nga energjia elektrike si burimi kryesor i energjisë, me pak qymyr, gaz dhe naftë për procese industriale të caktuara.
- Kjo varësi thelbësore nga energjia elektrike me bazë qymyri nënkuption që mjeshtë i ndërtuar dhe aktivitetet e sektorit ekonomik kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në emetimet e GS-së.
- Kosova historikisht ka pasur energji elektrike shumë të lirë, e cila ka rezultuar në joeficiencë të rrënjosur në konsumin e energjisë elektrike.
- Një eficiencë më e madhe do të kontribuojë në objektivat e zbutjes së ndryshimeve klimatike, por gjithashtu do të rezultojë në kursime financiare dhe efikasitet ekonomik.
- Megjithatë, kostot fillestare kapitale dhe kostot e larta të transaksionit që lidhen me zbatimin e masave të eficiencës së energjisë veprojnë si pengesë për konsum, pavarësisht qëndrueshmërisë financiare.

Zhvillimi i Planit Komunal i veprimit për Energji dhe Klimë, në fund do të thotë të përcaktohen objektivat dhe të identifikohen masat. Këto objektiva do të jen informacioni se sa mund të kursehet ose sa mund të reduktohen GS-të. Për ta bërë këtë, një nga sfidat për komunat mbetet vendosja e vitit referues si vit bazë me të cilin mund të krahasohen objektivat e reja. Bazuar në praktikat e tjera, kur mungojnë të dhënat, viti referues kriohet në bazë të disponueshmërisë së datës që komuna është në gjendje ta sigurojë (rekomandimi nga BE-ja është që të merret viti 1990, në rast të mungesës së të dhënavë, pastaj viti referues mund të kriohet vetëm për atë vit që të dhënat janë të disponueshme, duke shkuar prapa).

Hapat e përgjithshëm që duhen ndërmarrë për zhvillimin dhe zbatimin e PKVEK-së janë si në vijim:



Fig. 3-1 Hapat për zhvillimin dhe zbatimin e PKVEK-së

PKVEK është dokument ndërsektorial ku të gjithë sektorët do të merren parasysh për analizimin e konsumit të energjisë, gjenerimit të BRE-së dhe emetimit të CO<sub>2</sub> (p.sh. ndërtuesat publike, ndriçimi rrugor, transporti, sektori i banimit, sektori i ndërtesave komerciale, sektori i bujqësisë dhe sektori i shërbimeve).

Hapat e komunës për zhvillimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë janë si më poshtë:


- Vendosja e objektivave dhe masave të integruar përmes PKVEK-së në zhvillimin e përgjithshëm dhe bashkimi i ideve për zbatimin e strategjive lokale.
- Emërimi i stafit profesional për hartimin e PKVEK-së, planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë: aplikimi i masave për eficiencë të energjisë, aplikimi i teknologjive të energjisë së ripërtërishme dhe lëndëve djegëse ekologikisht të pranueshme.
- Vlerësimi Financiar dhe ndarja buxhetore për zbatimin e PKVEK-së.
- Mbështetja e zbatimit të masave të planifikuara për të gjithë periudhën kohore të PKVEK-së
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të miratuar, si dhe monitorimi i reduktimit të GS-së(dinamika e zbatimit të PKEK-së deri në vitin 2030);
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të aktorëve kryesorë dhe palëve të tjera të interesit gjatë periudhës së zbatimit të PKVEK-së.
- Ofrimi i vazhdueshëm i informacionit tek qytetarët për të ngritur vetëdijen me qëllim rritjen e shkallës së zbatimit të masave sipas PKEK-së.

#### **4. PROCESI I MIRATIMIT TË PLANIT KOMUNAL PËR ENERGJINË DHE KLIMËN**

Para fillimit të çfarëdo procesi për zhvillimin e PKVEK-së, hapi fillestar është identifikimi i palëve të interesit dhe angazhimi i tyre në proces, për të krijuar një komitet të dedikuar për të trajtuar detyrat e komunës për energjinë dhe klimën. Kjo është një mënyrë për të vendosur çështjet e energjisë dhe klimës në agjendën politike lokale. Hapi i parë do të jetë të kërkohet nga administrata komunale që të hartoje një plan për energjinë dhe klimën. Punonjësit e komunës, palët lokale të interesit (drejtoritë komunale, shoqatat banesore, biznesi dhe/ose industria, banorët dhe konsulentët e jashtëm, (agjencia pyjore, shoqatat e ndryshme kur kërkohet) dhe palët e interesuara duhet të punojnë së bashku në proces dhe ofrojnë mbështetje. Palët e mundshme të interesit për zhvillimin e një plani të tillë janë:

- Drejtoritë komunale,
- Shërbimet publike
- Organizatat e shoqërisë civile (OJQ-të)
- Ekspertët
- Përfaqësuesit tjerë të sektorëve (p.sh. shoqatat e pronarëve të shtëpive, shoqatat e kompanive të ndërtimit, shoqatat e tregtarëve me shumicë, ... etj)

Hapi tjetër i rëndësishëm është që Komuna të ketë strukturat e menaxhimit të Energjisë – të emërojë menaxherin e energjisë që në fillim. Diagrami për rrjedhën e procesit dhe komunikimin ndërmjet niveleve të ndryshme për sistemin e menaxhimit të energjisë është pëershruar në tabelën e mëposhtme.



*Fig. 4-1 Struktura komunale për menaxhimin e energjisë dhe komunikimin*

Hapi tjetër është procesi i mbledhjes së të dhënave. Të dhënat për zhvillimin e PKVEK-së mund të mblidhen nga institucionet e mëposhtme.

- Agjicioni i Statistikave të Kosovës
- Administrata e Tatimit në Pronë
- Urbanizmi
- Të dhënat klimatike nga Instituti Hidro Meteorologjik

Formimi i planeve strategjike kombëtare dhe komunale

- Strategjia për energjinë
- Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike
- Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2019/2021
- Plani Zhvillimor Komunal
- Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
- Inventarët e emetimit të GS.
- Hartat zonale komunale
- Korniza buxhetore afatmesme komunale

Procesi hap pas hapi është paraqitur në diagramin më poshtë.




Fig. 4-2 Miratimi hap pas hapi i PKVEK-se

## 5. PROCESI I ZBATIMIT TË PKVEK-SË

Zbatimi i planit është procesi më i rëndësishëm, i cili kërkon njohuri dhe mjete për të kaluar nga plani në veprim. Plani duhet të përfshijë një veprim të menaxhueshëm me role dhe përgjegjësi të dakorduara për masat dhe aktivitetet e identikuara, duke përfshirë investimin në opzioni financiare dhe përfitimet e pritshme.

“Frutat që vilen lehtë” - pra fillimisht përzgjidhen ato masa dhe aktivitete më të lehta për t'u zbatuar dhe më pas zbatimi duhet të vazhdojë duke rritur gradualisht kompleksitetin e ndërhyrjeve. Megjithatë, qasja strategjike duhet të fokusohet në një perspektivë afatgjatë ku përfitimet si intensiteti i energjisë, reduktimi i konsumit të energjisë dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serrë të janë përmirësuar ndjeshëm.

Përfitimet e pritshme nga zbatimi i PKVEK-së janë si në vijim:

- Përmirësimi i EE-së në të gjithë sektorët, proceset e prodhimit dhe aplikimi i teknologjive të BRE-ve me synim reduktimin e ndikimit negativ në mjedis, rritjen e produktivitetit dhe pjesëmarrjes së BRE-ve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në territorin komunal.
- Planifikimi më i mirë dhe optimizimi i shërbimit publik; furnizimi me ujë, grumbullimi i mbeturinave dhe ndriçimi publik i rrugëve.
- Kursimi i energjisë dhe rritja e investimeve në sektorin e energjisë përmes têrheqjes së (Institucion Financiare Ndërkombëtare) IFN-ve të ndryshme si dhe investimeve private nëpërmjet PPP-së (Partneritetit Publiko Privat) ose KSHE-ve (Kompanive të Shërbimeve të Energjisë).
- Rritja e të hyrave lokale/buxhetit komunal për investime kapitale, nëpërmjet reduktimit të konsumit të energjisë me zbatimin e masave të kursimit të energjisë.
- Kontributi në përbushjen e detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret kombëtare, përfshirë ato për arritjen e synimeve dhe objektivave kombëtare, disa prej të cilave rrjedhin nga PKEK dhe PKBRE (Plani Kombëtar i Veprimit për BRE).

Udhëzuesi për zbatimin e masës së përzgjedhur nga plani është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Fig. 5-1 Udhërrëfyesi për zbatimin e masës së përzgjedhur

## 6. MONITORIMI RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI

Montorimi dhe raportimi i zbatimit te planeve Komunale është obligim ligjor. Autoritetet komunale janë të obliguar që të raportojnë ne Agjensionin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në baza të rregullta vjetore, ligji për Eficiencë të Energjisë përcakton se deri më 30 qershori të çdo viti, AKEE përgatit raportin e progresit mbi implementimin dhe arritjen e caqeve vjetore të eficiencës së energjisë. Rekomandohet të përdoret platforma e monitorimit dhe verifikimit (MVP), kurdo që është e mundur, në llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe raportimit mbi masat e PKVEK.

Sipas ligjit ne fuqi çdo vit dhe jo më vonë se data 30 prill, Kuvendi Komunal miraton dhe ia dorëzon AKEE raportin e progresit për zbatimin e Planit Komunal për Eficiencën e Energjisë për vitin paraprak. Komunat duhet të përdorin platformën e veçantë të softuerit dhe ose faqen e të dhënave për raportim.

Komunat monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e caqeve të kursimit të energjisë. Për këtë qëllim, komunat duhet të krijojnë dhe menaxhojnë një sistem informacioni për mbledhjen e të dhënave për konsumin e energjisë në ndërtesat komunale dhe monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, duke përdorur platformën e bazuar në faqen zyrtare elektronike për raportim, Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP).




Fig. 6-1 Procesi I MVP

Me kete platforma është e mundur të monitorohen zbatimi i Planit Kombëtar në nivel shtetëror, planet dhe programet në nivel komunal. Raportimi është përshtatur me këtë strukturë dhe është e mundur të krijohen lloje të ndryshme raportesh të grupuara sipas njësive administrative në të cilat zbatohen masat e eficiencës së energjisë. Fakti që është e mundur të monitorohet zbatimi i planeve të ndryshme në nivele të ndryshme administrative është në fakt ajo që e bën PMV-në një mjet unik. Platforma në fund do të jetë në gjendje të prodhojë raporte përfundimtare për raportim tek sekretariati i komunitetit të energjisë mbi zbatimin e Direktiva për Eficiencë të Energjise DEE-së dhe Direktiva për Përformancën Energetike të Ndërtesave - DPEN-së.

## II. KAPITULLI II – PROCESI HAP PAS HAPI PËR ZHVILLIMIN E PKVEK-SË

### 1. IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESIT DHE ANGAZHIMI I TYRE

Krijimi i një plani komunal të veprimit për energjinë dhe klimën është shumë i rëndësishëm për të siguruar konsistencën midis masave të ndryshme që do të zbatohen, duke përfshirë ato të kryera nga aktorë të tjerë (për shembull, sektori privat) në territorin e komunës.

Është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet një qasje strategjike drejt energjisë së qëndrueshme dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike që mund të përfitojë nga mundësitet që mund të lindin nga përpjekjet (siç janë investimet) në këto fusha. Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë përcakton vizionin dhe ambicjet e Komunës për adresimin e veprimeve të integrueshme në fushën e Eficiencës së Energjisë (EE), Energjisë së Ripërtërishme (ER) dhe reduktimit të CO<sub>2</sub> në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Në përgatitjen e planit komunal, komuna duhet të përkujdeset që të ofrojë një pasqyrë të qartë se cilat janë detyrimet ndaj nivelit qendor, cilat janë pritet e banorëve vendës

dhe palët e tjera kyçe të interesit, çfarë është e arritshme duke pasur parasysh burimet dhe potencialet e Komunës dhe vizionin e përgjithshëm komunal që duhet përbushur. Një vizion i tillë i Komunës dhe objektivat përkatëse mbështeten nga objektivat kombëtare të vendosura nga niveli qendror përmes zhvillimit të planit kombëtar të energjisë dhe klimës.

Aspektet kryesore që duhen marrë parasysh gjatë krijimit dhe zbatimit të një plani efektiv komunal për Energjinë dhe Klimën janë:

- angazhimi politik
- Qasja pjesëmarrëse, pjesëmarrje në shumë nivele duke përfshirë palë të ndryshme të interesit
- Jo qasje që i përshtatet të gjithëve, duke marrë parasysh se komunat e ndryshme kanë potencial të ndryshëm dhe modele të ndryshme ekonomike dhe sociale.
- Mbledhja e plotë e të dhënavëve dhe analiza e të dhënavëve – të kuptuarit e nxitësve për ndryshimin e konsumit të energjisë
- set i gjërë veprimesh, qasja e bazuar në skenar
- përgjegjësi të qarta operacionale
- planifikimi i burimeve të duhura
- Informacioni i disponueshëm për publikun dhe i shpërndarë kudo.

Nga viti 2011, institucionet e nivelit qendror kanë zhvilluar (PKVEE) Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë duke përfshirë planin e ndërmjetëm trevjeçar të zbatimit. Sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë, Komunat janë të obliguara të hartojnë Planin e Veprimit Komunal për Eficiencë të Energjisë që mbulon periudhën trevjeçare. Nga viti 2021, Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) do të zëvendësohet me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), një plan që integron energjinë dhe klimën dhe vendlodhet me objektivat përfshirë EE, ER dhe reduktimin e CO<sub>2</sub> për periudhën 2021-2030. Pothuajse të gjitha Planet Komunale të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) që mbulojnë periudhën 2019-2021 duhet të rishikohen në përputhje me objektivat kombëtare. Prandaj, kërkesat e raportimit ndaj Agjencisë Kosovare përfshirë Eficiencë të Energjisë (AKEE).

PKVEK-ja është dokument strategjik vendor që ofron veprime dhe masa që duhen zbatuar përritjen e një qëllimi të caktuar, si dhe ofron informata për procedurat e monitorimit dhe verifikimit, si dhe kërkesat e raportimit ndaj Agjencisë Kosovare përfshirë Eficiencë të Energjisë (AKEE).

Lista e mëposhtme paraqet palët e interesit potencialisht të rëndësishme në kontekstin e një PKVEK-je:

- Autoriteti lokal: departamentet përkatëse komunale dhe kompanitë publike (ndërmarrjet komunale të energjisë dhe ujësjellësit, kompanitë e transportit, et)
- Agjencitë/shoqatat lokale dhe rajonale te energjisë
  - Përfaqësues të administratave kombëtare/rajonale dhe/ose bashkëpunimit/autoriteteve ndërkumunale, përfshirë siguruar koordinim dhe konsistencë me planet dhe veprimet që zhvillohen në nivele të tjera
    - Partnerët financiarë si bankat, fondet private, KSHE-të,
    - Akterët institucionalë si oda ekonomike, oda e arkitektëve dhe inxhinierëve
- Sektori i ndërtimit: shoqatat-kompanitë ndërtimore, sipërmarrësit, autoritetet banesore
- Akterët e transportit/mobilitetit: kompanitë e transportit privat/publik, etj.
- Shërbimet e furnizuesit të energjisë
- Bizneset dhe industritë që operojnë në nivel komunal
- Mbrojtja civile (p.sh. departamentet e policisë dhe zjarrit)

- Universitetet, shkollat dhe qendrat/institutet kërkimore
- Sektori i shëndetësisë
- Komuniteti bujqësor, aty ku është e përshtatshme
- Mediat

## 2. MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI/ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Qasja në statistika të përditësuara për konsumin e energjisë, gjenerimin e BRE-ve dhe emetimet e gazeve serrë për komunën është e rëndësishme se kur fillon puna për planin e energjisë dhe klimës.

Të dhënat e energjisë nuk grumbullohen përgjatë vijave të kufijve komunalë, prandaj detyra e krijimit të një ideje rreth energjisë lokale, për komunat individuale është shumë komplekse. Në lidhje me zhvillimin e PKVEK-së, ekzistojnë disa vështirësi si më poshtë:

- Në nivelin komunal, të dhënat për lëndët djegëse të lëngshme nuk janë në dispozicion
- Konsumi i energjisë elektrike nuk matet sipas kufijve komunalë
- Qymyri dhe GLN nuk janë të disponueshme në nivel komunal prandaj është e vështirë të përcaktohet sasia
- Drunjtë e zjarrit dhe përdorimet e ndryshme të biomasës janë gjithashtu vështirë të matshme në nivel komunal

Megjithatë, është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera kombëtare, agjencitë, kompanitë publike dhe organet e tjera për të siguruar sa më shumë të dhëna të besueshme dhe për të përgatitur një plan real. Të dhënat e konsumit të energjisë dhe prodhimit të energjisë do të mblidhen në të gjithë sektorët në nivel komunal.

### Sektorët dhe nënsektorët e konsumit të analizuar të energjisë në komunë



Fig. 2-1 Sektorët dhe nënsektorët e analizuar për konsum

Të dhënrat e nevojshme që do të mblidhen për të llogaritur/modeluar konsumin e energjisë në të gjithë sektorët përkatës janë si më poshtë:




Fig. 2-2 Mbledhja e të dhënave për konsum të energjisë për sector të ndryshëm

Burimet për mbledhjen e të dhënave:

Enti i Statistikave të Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji, KEDS, Zyra e Tatimit në Pronë, Drejtoritë Komunale (shëndetësi dhe mirëqenie sociale, shërbime publike, urbanizëm, arsim, bujqësi dhe pylltari, kulturë, financa, ...), Zyra për Regjistrimin e Automjeteve, Shërbimet Publike Lokale – Kompanitë, ...

### **Prodhimi i energjisë përfshin impiantet konvencionale dhe burimet e ripërtërishme të energjisë.**

Planifikimi i burimeve energetike do të qartësojë gjerësinë gjeografike që ka komuna në lidhje me zhvillimin e sistemit energjetik dhe do të përbëjë gjithashtu një pjesë të rëndësishme të bazës së vendimmarres për masat e mundshme. Mirëpo, varësisht se çfarë do të jenë kompetencat e nivelit lokal me legjislacionin e ri, në PKVEK mund të trajtohen edhe resurset lokale për prodhimin e energjisë elektrike per konsum vetanak, p.sh. zhvillimi i kapaciteteve fotovoltaikë, energjia e erës, kogjenerimi si dhe gjenerimi lokal për ngrohje/ftohje.

#### **Gjeneratorë konvencionalë**

- Termocentralet
- Termocentrale me gaz
- Të tjera

#### **Burimet e ripërtërishme të energjisë**

- Hidrocentralet e vogla
- Gjeneratorët me erë
- Impiantet fotovoltaikë
- Impiantet diellore termike
- Pompat të nxehësië

#### **Ngrohja nga qyteti**

- **Ngrohja konvencionale nga qyteti me lëndë djegëse fosile**
- Sistemi kombinuar te energjise (Energji termike dhe elektrike)
- Të tjera

*Fig. 2-3 Llojet e gjeneratorëve te energjise*


Burimet për mbledhjen e të dhënave:

Enti i Statistikave të Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji, KEDS, Drejtori të Komunale (shëndetësi dhe mirëqenie sociale, urbanizëm, arsim, bujqësi dhe pylltari, kulturë,...), Shërbimet Publike Lokale-Kompanitë

### Prodhimi i energjisë në të gjithë sektorët dhe nënsektorët e komunës


Gjeneratorët komerciale nuk janë nën administrimin lokal, prandaj të dhënat për prodhimin e energjisë për këta lloj gjeneratorësh duhet të mbledhen nga autoriteti qendror përkatës që është posedues i një gjeneratori të tillë, ose nga prodhuesit e energjisë.

Megjithatë, komuna do të mbledhë të dhënat për prodhimin e energjisë nga gjeneratorët për vetë-konsum. Sipas legjislacionit në fuqi, Rregullës për Skemën Mbështetëse, të gjithë konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV kanë të drejtën e instalimit të gjeneratorit për vetë-konsum dhe kapaciteti nuk duhet të jetë më i lartë se përqimi elektroenergetik i dhënë nga kompania e shpërndarjes, ndërsa konsumi i energjisë duhet të jetë konsumi mesatar vjetor. Ky lloj gjeneratori duhet të marrë lejen e ndërtimit nga komuna, përqimin elektroenergetik dhe konsumin vjetor të energjisë nga Kompania e Shpërndarjes si dhe autorizimin nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) për të hyrë në punë, prandaj njëra nga këto institucione mund të jetë një nga burimet e të dhënave për të mbledhur gjenerimin e energjisë.



\* Nëse ka të dhëna në dispozicion

Fig. 2-4 Prodhimi I energjisë në sektorin e ndërtesave



\* Nëse ka të dhëna në dispozicion

Fig. 2-5 Prodhimi I energjisë në sektorët tjerë

### 3. IDENTIFIKIMI I MASAVE DHE PËRCAKTIMI I SKENARËVE

#### Renditja e Masave për Eficiencë te Energjisë dhe Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE)

Ky kapitull ofron sugjerime dhe shembuj të politikave dhe masave që mund të miratohen nga autoriteti lokal. Ai përqendrohet në politikat dhe masat që në përgjithësi do të ofrojnë reduktim të CO<sub>2</sub> ose kursim të energjisë në një afat më të gjatë.

Politikat dhe masat në lidhje me Eficiencën e Energjisë që synojnë reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> si dhe Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në nivel lokal mund të kategorizohen në sektorë të ndryshëm:

- **ndërtesat, duke përfshirë ndërtesat e banimit dhe ato komunale**

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe situatën reale në Komunë, masat e EE-së dhe masat e BRE-ve për sektorin e ndërtesave ndahen në nënkategorië e mëposhtme:

### Masat e EE-së dhe BRE-ve në sektorin e ndërtimit

- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative
- Masat e EE për ndërtesat në pronësi të Komunës
- Masat e EE për sektorin e banimit në Komunë (Amvisri)
- Masat e EE për ndërtesat komerciale dhe të shërbimit
- Masa BRE - Instalimi i impianteve fotovoltaikë
- Masa BRE - Instalimi i termocentraleve Diellore
- Masa BRE - Instalimi i pompave termike
- Masa BRE - Implementimi i impiantit të vogël të kombinimit të nxehësisë dhe energjisë

Fig. 3-1 Masat EE dhe BRE në sektorin e ndërtesave

Ndërhyrjet strategjike të rëndësishme për eficiencë të energjisë, duke marrë parasysh 'shtrirjen' komunale, ndikimin në kursimin e energjisë, janë:

- Termoizolim i mbështjellësit të ndërtesës
  - Ndërrimi i dritareve me xham të dyfishtë ose trefishtë me emetim të ulët
  - Ndërrimi i sistemit të ngrohjes me një më efikas
  - Instalimi i sistemit efikas të ndriçimit LED
  - Instalimi i Sistemit per menaxhim të energjisë ne ndertese
  - Instalimi i valvulave balancuese TRV,
  - ndriçim eficient për familjet me të ardhura të ulëta
  - Përmirësimi i eficiencës (pompë termike ose/dhe SWH) i pajisjeve për ngrohjen e banesave dhe ngrohjen e ujit nëpërmjet mbështetjes dhe skemave të tjera,
  - përmirësimi i eficiencës së sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit (NVK) në sektorin komersial – nëpërmjet informacionit dhe skemave të tjera
- **transporti, duke përfshirë automjetet publike dhe private**

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe situatën reale në Komunë, masat e EE-së dhe masat e BRE-ve për sektorin e transportit ndahen në nënkatgoritë e mëposhtme:

### Masat e EE dhe BRE në sektorin e transportit

- Zhvillimi i planeve të integruara të transportit lokal
- Zhvillimi i mjeteve të transportit jomotorik
- Zhvillimi dhe përmirësimi i modalitetave të transportit publik
- Mbështetja dhe promovimi i biokarburanteve dhe eficiencës së lëndëve djegëse
- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative
- Prokurimi Publik i Gjelbër
- Masat për automjetet në pronësi të Komunës
- Masat e transportit publik
- Masa për automjete private dhe komerciale
- Masat e BRE (Impiantet fotovoltaikë, centralet diellore, pompat ngrohëse)

Fig. 3-2 Masat EE dhe BRE në sektorin e transportit

Ide të rëndësishme ose interesante për të çuar përpara: është fillimi i pilotimit të qasjeve funksionale të planifikimit rajonal duke integruar planin e transportit publik si një qasje praktike më e mirë për komunat dhe zonat urbane dytësore dhe ato më të vogla.

Mesazhi duhet të përkthehet në atë që ka rëndësi për njerëzit: cilësia e jetës, siguria e fëmijëve, lehtësimi financiar, shëndeti dhe cilësia e jetës, vendet e punës.

- **shërbimet publike,**

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe situatën reale në Komunë, masat e EE-së dhe masat e BRE-ve për shërbimet publike ndahen në nënkatgoritë e mëposhtme:

#### **Masat e EE dhe BRE në sektorin e shërbimeve publike**

- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative
- Prokurimi Publik i Gjelbër
- Masat për furnizimin me ujë dhe ujërat e zeza
- Masat për grumbullimin/menaxhimin e ujit
- Masat e BRE-ve (Implantet fotovoltaik, termocentralet diellore, pompat ngrohëse)
- Opsonet e Biogazit nga mbeturinat dhe ujërat e zeza

Fig. 3-3 Masat EE dhe BRE në sektorin e shërbimeve publike

- **Bujqësia**

Kërkesa për energji mund të reduktohet në të gjitha proceset bujqësore ku përdoret energia, nga ndryshimet e duhura teknologjike, si dhe nga përmirësimi i menaxhimit dhe funksionimit.

Prodhimi bujqësor dhe përpunimi industrial janë gjithashtu shumë të varura nga energjia elektrike si burimi kryesor i tyre i energjisë. Varësia e konsiderueshme në energjinë elektrike me bazë qomyri do të thotë që mqedisi i ndërtuar dhe aktivitetet e sektorit ekonomik kontribuojnë në mënyrë thelbësore në emetimet e Gazrave Serrë.

Një shembull ku kursimi i energjisë mund të zbatohet në proceset bujqësore është i prezentuar në ilustrimin më poshtë.




Fig. 3-4 Kursimet energjetike në proceset bujqësore

Garantimi që burimet do të përdoren në një mënyrë të dobishme për shoqërinë, përfshin marrjen parasysh të faktit që burimet do të asgjësohen me qëllim të nevojave të brezave të ardhshëm. Menaxhimi i burimeve të tokës duhet të jetë i shëndoshë për mjedisin dhe, ndër të tjera, të marrë në konsideratë mbrojtjen e dheut si faktor prodhimi dhe ruajtjen e tokës dhe peisazheve bujqesore si bazë për jetën, shëndetin dhe mirëqenien për qeniet njerëzore, kafshët dhe bimët.

Ndryshimet në përdorimin e tokës si prerja e pyjeve, mbjellja e pyjeve dhe tranzicioni nga toka bujqësore në zone banimi dhe komerciale ose rrugët gjithashtu ndryshojnë emetimet e gazrave serrë nga këto zona. Disa nga elementët e mësipërm ndikojnë në emetimet e  $N_2O$ , veçanërisht kultivimi i ri dhe intensiteti i plehërimit.

Pylltaria dhe buqesia gjithashtu mund të ofrojnë lëndët e para për bioenergji. Në shumë komuna rurale, emetimet e gazrave serrë nga bujqësia janë përgjegjës për një pjesë të konsiderueshme të emetimeve të gazrave serrë të komunës. Prandaj, në shumë komuna është e rëndësishme përfshirja e këtij sektori në planin e energjisë dhe klimës.

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe situatën reale në Komunë, masat e EE-së dhe masat e BRE-ve për sektorin e buqesise ndahan në nënkatgoritë e mëposhtme:

### Masat e EE dhe BRE në sektorin e Bujqësisë

- Opcionet e Biogazit nga Bujqësia dhe Pylltaria
- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe educative
- Masat e BRE (Impiantet fotovoltaikë, termocentralet diellore, pompat ngrohëse)

Fig. 3-5 Masat EE dhe BRE në sektorin e buqësisë

- Ndriçimi publik

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe situatën reale në Komunë, masat e EE-së dhe masat e BRE-ve për ndriçimin publik ndahen në nënkategori të mëposhtme:

### Masat e EE dhe BRE në ndriçimin publik

- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative
- Prokurimi Publik i Gjelbër
- Instalimi i sistemit efikas të ndriçimit LED
- Instalimi i sistemit të ri inteligjent të kontrollit të ndriçimit
- Masat e BRE-ve (Impliantet fotovoltaikë)

Fig. 3-6 Masat EE dhe BRE në ndriçimin publik

### Vlerësimi i kostos së investimit

Zbatimi i suksesshëm i PKVEK-së kërkon burime të mjaftueshme financiare. Prandaj është e nevojshme të identifikohen burimet financiare në dispozicion, si dhe skemat dhe mekanizmat për alokimin e këtyre burimeve në mënyrë që të financohen veprimet e PKVEK-së. Vendimet lidhur me finançimin duhet të janë në përputhje me rregullat e buxhetit publik dhe paratë e gatshme të gjeneruara nga përmirësimet e eficiencës së energjisë dhe reduktimet e faturave të energjisë nga zbatimi i teknologjisë së BRE-ve. Kjo mund të çojë në një reduktim të burimeve financiare në periudhën e ardhshme buxhetore. Kjo përfaktin se më së shpeshti projektet e EE-së financohen përmes buxheteve të shpenzimeve kapitale, ku faturat e energjisë paguhën nga buxhetet operative. Në shqyrtimin e kostove të zbatimit, autoritetet lokale duhet të marrin parasysh edhe përfitimet e tyre të përbashkëta: përfitimet për shëndetin, cilësinë e jetës, punësimin, atraktivitetin e qytetit, etj.

Skemat më të rëndësishme të financimit janë:

1. Buxheti lokal
2. Fondet rrotulluese
3. Skemat e financimit nga palët e treta
4. Kompanitë e Shërbimeve të Energjisë - KSHE -ESCO

Për çdo masë/veprim, është e rëndësishme të jepet një pëershkim i përgjithshëm, organi përgjegjës, koha (fillimi-përfundimi, momentet kryesore), kursimi i vlerësuar i energjisë/rritja e prodhimit të energjisë së ripërtërishme dhe reduktimi i vlerësuar i CO<sub>2</sub>, vlerësimi i kostos dhe gjithashtu financimi/burimet.

Autoritetet lokale mund të përdorin metodologjinë e tyre për të vlerësuar koston e zbatimit sipas diagramit më poshtë:




Fig. 3-7 Metodologjia për vlerësimin e kostove

Burimet për mbledhjen e të dhënave për vlerësim:

Furnizuesit lokalë të teknologjisë për EE dhe BRE, Kompanitë e ndërtimit, Zyra e prokurimit dhe Përvoja nga projektet e mëparshme të zbatuara nga fusha të ngashme

#### **Modelimi i kursimit të energjisë për skenarë të ndryshëm dhe reduktimi i CO<sub>2</sub>**

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe në grupet e ndryshme të masave, mund të jetë e rëndësishme të përcaktohen skenarët: si do të evoluojë konsumi i energjisë, burimet e ripërtërishme të energjisë dhe emetimet e CO<sub>2</sub> sipas politikave aktuale dhe cili do të jetë ndikimi i veprimeve të parashikuara? Mund të jetë e përshtatshme të ndërtohet një skenar "Biznes i Zakonshëm" (BIZ), për të parashikuar nivelin e konsumit të energjisë dhe emetimet e CO<sub>2</sub> gjatë vitit(eve) të synuara në një skenar pa zbatimin e masave sipas PKVEK-së, dhe një skenar me zbatimin e masave të EE-së sipas PKVEK-së.

Skenari i Biznesit të Zakonshëm (BIZ) është skenari bazë që supozon rritjen e konsumit të energjisë në përputhje me trendet e tregut dhe shprehitë e konsumatorit, pa zbatimin sistematik të masave të eficiencës së energjisë, por duke supozuar zbatimin e produkteve dhe shërbimeve të reja teknologjike të avancuara të disponueshme në treg për periudhën deri në vitin 2030.

Skenari i Efiçencës së Energjisë merr parasysh reduktimin e konsumit të energjisë, zbatimin e teknologjisë së BRE-ve dhe masave për reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> deri në vitin 2030 përmes zbatimit të të gjitha masave të identifikuara për efiçencën e energjisë dhe BRE-ve për ndërtesat, transportin, shërbimet publike, agronominië dhe ndriçimin publik.

Modelimi i skenarëve merr parasysh qëndrueshmërinë teknike dhe financiare, duke renditur projekte sipas kursimeve të energjisë, reduktimit të emetimit të CO<sub>2</sub> si dhe Periudhës së Kthimit të Investimit (PKI), Normës së Brendshme të Kthimit (NBK) dhe Vlerës Aktuale Neto (VAN). Prioritet duhet t'u jepet projekteve me qëndrueshmëri të sigurtë teknike dhe financiare.

Llogaritjet e kursimeve të energjisë të masës specifike mund të bëhen përmes mjeteve të mëposhtme: ENMASOFT, softueri për certifikimin e performacës energetike në ndërtesa iSBMXK dhe MVP.

#### **Potenciali i përgjithshëm për kursime të energjisë sipas sektorëve**

Masat janë të ndara në nënsektorë, ku për secilën masë vlerësohen kursimet potenciale të energjisë, gjenerimi i BRE-ve dhe reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> deri në vitin 2030 krasuar me vitin referues. Kursimet kumulative të energjisë të arritura si rezultat i zbatimit të masave të ndryshme duhet të paraqiten për çdo sektor, si dhe kontributin e tyre në kursimet totale të energjisë, p.sh. pothuajse 40%, përllogaritet të arrihet nga familjet, pasuar nga transporti dhe industria, me kontribut deri në 30%, dhe sektorët e tjera (sektori i shërbimeve dhe agronomia 30%)

*Tab. 3-1 Potenciali për kursime energetike sipas sektorëve*

Kursimet totale të energjisë sipas sektorëve në ktoe (ose MWh)										Gjithsej
Sektori	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	
Rezidencial										
Ndërtesat publike*										
Transporti										
Sektori i shërbimit/komercial										
Bujqësia										
Gjithsej sipas vitit										

#### **4. FINALIZIMI DHE MIRATIMI I PLANIT**

Procesi i hartimit të PKVEK-së është një proces sfidues dhe që kërkon kohë e që duhet të planifikohet sistematikisht dhe të menaxhohet në vazhdimësi kur është fjala përf finalizimin e tij. Ai kërkon bashkëpunim dhe koordinim dhe pëlqim të përbashkët ndërmjet departamenteve të ndryshme në administratën lokale, si Drejtoria e shërbimeve publike (mbrojtja e mjedisit, mobiliteti dhe transporti), Drejtoria e Urbanizmit (përdorimi i tokës, planifikimi hapësinor, ndërtesat dhe menaxhimi i infrastrukturës), Drejtori të përf Ekonomi (buxheti dhe financat, prokurimi), Çështjet sociale (varfëria energjetike), etj.

Gjithashtu, një nga sfidat përf tē pasur sukses është se procesi i PKVEK-së nuk duhet të konceptohet nga departamentet e ndryshme të administratës lokale si një çështje e jashtme, por duhet të integrohet në jetën e tyre të përditshme: mobiliteti dhe planifikimi urban, menaxhimin e aseteve të autoritetit lokal (ndërtesat, flota komunale, ndriçimi publik...), komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm, prokurimi publik, etj. Një strukturë e qartë organizative dhe caktimi i përgjegjësive janë parakushte përf implantimin e suksesshëm dhe tē qëndrueshëm.

Pas përpilimit tē draft planit, kërkon që çdo Drejtori/departament apo njësi që mund tē afektohen gjatë zbatimit ta komentojë atë- tē japo komentet/inputet e veta.

Mungesa e koordinimit ndërmjet politikave të ndryshme, departamenteve/njësive të autoritetetve lokale dhe/ose organizatave të jashtme (d.m.th. Organizata e Shoqërisë Civile OSCH), ndikon në cilësinë e planit dhe mund tē prodhojë mangësi në fusha të ndryshme kur bëhet fjalë përf zbatimin e tij.

Një përfshirje e tillë ndërinstitucionale dhe e mirëkoordinuar shpie në një plan efektiv dhe tē strukturuar që ka masa dhe veprime reale dhe është i zbatueshëm.

Pas përfundimit tē konsultimeve të brendshme dhe arritjes së marrëveshjes së ndërsjellë, hapi tjetër është dërgimi i planit përf miratim në kuvendin komunal.Duke qene se Plani Kombtar per Energji dhe Klime ende nuk eshte bere dokument ligjërisht i detyreshem, një hap i till do te behet vetëm pasi Plani Kombtar te aprovohet ne nivelin qendror dhe mandej te përcillet me aprovin e planeve komunale te veprimit ne nivelin lokal.

Diagrami më poshtë paraqet qasjen hap pas hapi për miratimin e PKVEK-së.



Fig. 4-1 Adaptimi I PKVEK hap pas hapi

## 5. ZBATIMI I MASAVE DHE MEKANIZMI FINANCIAR

Një pjesë e konsiderueshme e energjisë së konsumuar kombëtare lidhet me aktivitetet që ndikohen nga mjedisi i ndërtuar dhe infrastruktura mbi të cilat qeveria komunale ka kompetenca dhe funksione të rëndësishme. Përvoja tregon se pa ndërryrje, konsumi i energjisë dhe emetimet e lidhura me to do të rriten me një ritëm të papranueshëm duke pasur parasysh kufizimet e burimeve dhe angazhimet për ndryshimin e klimës.

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve bazë falas, duke përfshirë energjinë, i takon pushtetit lokal. Përgjegjësitë në lidhje me eficiencën e energjisë janë relativisht të reja dhe duhet të institucionalizohen. Kjo është komplekse pasi eficiencia e energjisë kërkon qasje të reja dhe gjithash tu ndodh nëpër shumë sektorë. Ndërsa energjia e ripërtërishme nuk është mandat i pushtetit lokal si e tillë, por mund të futet në politikën dhe funksionimin e pushtetit lokal nëpërmjet ndjekjes së zhvillimit ekonomik lokal, çështjeve mjedisore dhe të qëndrueshmërisë dhe mjedisit të ndërtuar. Programi i qeverisë kombëtare për energjinë e ripërtërishme mund të ndikojë gjithash tu në pushtetin lokal meqenëse zhvillohet në zonat lokale, dhe gjithnjë e më shumë mund të "ngulitet" edhe në rrjetin e shpërndarjes së pushteteve lokale.

Fazat për zbatimin e suksesshëm janë si më poshtë.

**Faza 1: Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme të energjisë për të gjithë**

**Faza 2: Të bërit më eficient**

**Faza 3: Rritja e shërbimeve të energjisë së ripërtërishme dhe duke pasur gjithnjë e më shumë ekonomi lokale të dekarbonizuara**

Për të ndjekur një qasje të qëndrueshme për zbatimin e masave që rrjedhin nga plani krahas planifikimit investues dhe financier duhet të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve - mundësish përmes njësive teknike, trajnimit të stafit ekzistues
- Ofrimi i shembujve për gjenerimin e Energiise së Rinovueshme kryesish për vetëkonsum.
- Promovimi i partneritetit publiko-privat.
- Mbështetja e zhvillimit të partneritetit për zhvillimin e burimeve të ripërtërishme dhe eficiencës

- Platformat e rrjetëzimit, qendrat e inovacionit, shkëmbimi i njohurive
- Rëndësia e prakticizmit dhe zbatueshmërisë së projekteve; shmangja e teknologjive në gjendje të keqe

Në mënyrë të veçantë qasja hap pas hapi për zbatimin e masës së përzgjedhur është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.




Fig. 5-1 Implementimi hap pas hapi I masave të selektuara

### Aspektet teknike - Përgatitja e raportit të auditimit energjetik (përcjellja ose auditimi standard i energjisë)

Qëllimi i auditimit të energjisë është të përcaktojë dhe analizojë rrjedhën e energjisë në ndriçimin e ndërtesave dhe rrugëve dhe të vlerësojë masat e mundshme për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesës ose ndriçimit të rrugëve në tërësi dhe përbërësve të tij individualë.


Auditimi i energjisë do të bëjë të qartë nëse ndërtesa është duke funksionuar në mënyrën më të mirë të saj, ose nëse mund të bëhen përmirësimi për të rritur eficiencën e energjisë. Inspektimi dhe çdo përmirësim i rekomanuar do të ndihmojë në identifikimin dhe zbutjen e problemeve si temperaturat e pabarabarta në të gjithë hapësirën e brendshme të ndërtesës, draftet, faturat e larta të shërbimeve, çështjet e komoditetit dhe problemet e lagështisë.

Në Kosovë, auditimet e Energjisë kryhen nga Auditorët e certifikuar të Energjisë. Auditimet energjetike quhen ndonjëherë vlerësimi të energjisë, por pavarësisht nga emri i tyre, procesi i auditimit është duke hedhur hapin më të rëndësishëm në arritjen e ndërtimit me eficiencë energjetike apo ndriçimit rrugor.

Harta e procesit dhe hapat e ndërmarrë në vlerësimin e auditimit energjetik të ndërtesës dhe/ose ndriçimit rrugor janë ilustruar në figurën më poshtë:

## Auditimi i Energjisë

### Pasqyra e konsumit të energjisë dhe ujit për një ndërtesë



### Raporti Final i Auditimit të Energië

Fig. 5-2 Auditimi energetik, hap pas hapi

Shembulli i një auditimi energetik që adreson humbjet e nxehtësisë dhe fitimin e nxehtësisë përmes shtresave mbështjellëse të ndërtesës është paraqitur në figurën më poshtë.




Fig. 5-3 Shembull i auditimit energetik – humbjet e nxehtësisë dhe përfitimet e nxehtësisë

Aspektet teknike dhe administrative - Projektimi i detajuar, Prokurimi dhe Kontraktimi

Hartimi i projektimit të detajuar është procesi me të cilin përkthehet një masë individuale nga PKVEK (Eficiencë të Enërgjise ose Energji e Rinovueshme ose masa e reduktimit të Gazrave Serrë, instalimi ose projekti mjedisor) në zgjidhje fizike tredimensionale: të tilla si ndërtesat ose ndriçimi rrugor, ose të tjera përkthehet në projektimin arkitektonik, mekanik ose elektrik, duke pasur planimetrinë, specifikimet teknike dhe paramasën duke marrë parasysh standardeet dhe normat më të fundit në fuqi.

Një nga pikat fillestare për të kryer auditimin energjetik apo studimin e fizibilitetit përpara se të bëhet projektimi i detajuar për përgatitjen e një zgjidhjeje të mirë teknike është për shkak të dhe që duhet të merren parasysh; raporti i kursimit të energjisë, aspektet e kostos, vlera për para dhe shpërndarja më efektive. Përveç kësaj, qëllimi është maksimizimi i kursimit të energjisë, përmirësimi i gjendjes së komoditetit dhe reduktimi i emetimeve në shkallën më të lartë të mundshme.

Figura më poshtë paraqet procesin dhe hapat e ndërmarrë në projektimin, tenderimin dhe kontraktimin e punimeve për projektin e përzgjedhur nga plani:



Fig. 5-4 Procesi dhe hapat për projektimin, tenderimin dhe kontraktimin e punimeve

#### Zbatimi i punimeve dhe mbikëqyrja, lëshimi i Certifikatës së Përdorimit

Projektet e ndërtimit dhe/ose rinvimit shoqërohen me monitorim të vazhdueshëm të rrjedhave individuale të punës dhe hapave të procesit të ndërtimit/rinvimit. Defektet që nuk zbulohen në kohë gjatë prodhimit/furnizimit ose instalimit mund të çojnë në vonesa në finalizim dhe tejkalim të kostos. Ato shpesh lindin nga mospërputhja me standardeet e cilësisë në vend. Shpenzimet që duhet të kryhen për riparimin e defekteve dhe dëmtimeve, gjithashtu ndikojnë dhe rrisin kthimin në investim.

Mbikëqyrja/inspektimi i të gjithë fazës së ndërtimit, dokumentimi i progresit të projektit siguron dhe rrit transparencën dhe përcjelljen e projektit. Kjo mund të zbusë rrezikun përmes identifikimit të hershëm të problemeve. Vlerësimet individuale me sugjerime specifike për përmirësim do të ndihmojnë për të mbajtur projektin në rrugën e duhur dhe për të shmangur kostot që rezultojnë nga tejkalimi i afateve dhe vonesat e shkaktuara apo edhe nga arritura e qëllimeve të dëshiruara.

Plani i zbatimit është një proces kompleks, i cili ndikohet nga faktorë të ndryshëm që mund të jenë të direkt ose indirekt, siç paraqitet në figurën më poshtë.




Fig. 5-5 Implementimi i PKVEK

Hapi final para se të lëshohet certifikata e përdorimit është vlerësimi i performancës energjetike në ndërtesa si dhe lëshimi i certifikatës së performancës energjetike në ndërtesë, që së shpejti pritet të hyjë në fuqi dhe të zbatohet. Po ashtu si process tjetër është edhe inspektimi i sistemeve për ngrohje, ftohje dhe klimatizim. Inspektimi parashihet të bëhet për kaldaja me kapacitet mbi 100kW të instaluar, ndërsa sistemet përkondicionim të ajrit përfshihen të gjitha.

#### BURIMET KRYESORE TË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE INVESTIVE NË KOMUNA

Komunat duhet të sigurojnë se do të ketë aftësi adekuate financuese për shpenzimet e tyre të planifikuara nëse duan të "balancejnë buxhetin". Ekzistojnë burime të ndryshme të të hyrave që mund të përdoren nga komunat për të financuar zbatimin e Planeve Komunale të Veprimit për Energji dhe Klimë. Ky seksion përshkruan burimet e ndryshme të të hyrave komunale dhe përshkruan mënyrat për të vendosur se cilat do të janë më të përshtatshmet për ndarjen e fondeve.

Instrumentet kryesore të financimit në nivel komunal janë nga këto burime financiare.

- Të hyrat vetanake komunale,
- Grantet operative dhe të rakordimit,
- Huamarrja dhe zotimet komunale,
- Instrumentet ndërkombëtare të financimit INF.

- Financimi nëpërmjet sektorit bankar vendor
- Partneriteti publiko-privat
- Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
- Organizata të tjera financiare ndërkontaktore dhe programe mbështetëse të asistencës teknike

**Kontributet nga të hyrat** - Kur blini një artikull të vogël kapital, kostoja totale e vogël mund të paguhet nga të hyrat operative në vitin e blerjes. Ky burim financimi njihet si "kontributet nga të hyrat". Energjia nuk është kategori e veçantë në planet buxhetore komunale (prandaj ajo zakonisht realizohet nën kategorinë "mallra dhe shërbime" ose "investimet operative dhe kapitale"). Buxheti për këtë kategori përbëhet nga të hyrat komunale të mbledhura nga:

**Taksat dhe tatifit komunale:** (Taksat për pronën e paluajtshme, tarifat për licencimin e biznesit, taksat e automjeteve, taksat administrative komunale, tarifat për licencat dhe lejet për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve dhe strukturave të tjera, tarifat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të tjera zyrtare, etj)

**Taksat mbi pronën** - Të gjithë njerëzit dhe bizneset që zotërojnë pasuri të paluajtshme (tokë, shtëpi, fabrika dhe blloqe zyrash) në sipërfaqen e komunës ngarkohen me "Taksat e Pronës" - një taksë vjetore bazuar në vlerën e çdo prone. Të ardhurat nga tarifat përdoren nga komuna për të paguar shërbimet e përgjithshme për të gjithë njerëzit, të cilat nuk mund t'i tarifohen lehtësisht një përdoruesi të caktuar shërbimi si "pagesë shërbimi" për shembull rrugët, trotuaret, parqet, ndriçimin rrugor, rinnovimin e ndërtesave publike, menaxhimin e ujit të shiut etj.

**Grantet qeveritare** - Komunat mund të aplikojnë tek qeveria e vendit për grante për zhvillimin e infrastrukturës. Dy fondet kryesore në dispozicion janë:

**Donacionet dhe kontributet publike** – institucionet kombëtare ofrojnë donacione/grante për një investime kapitale për projekte të ndryshme të infrastrukturës komunale.

**Shpërndarja e barabartë** - Spërndarja e barabartë është një shumë e caktuar parash që i ndahet një komune nga qeveria e vendit çdo vit. Kushtetuta thotë se të gjitha të hyrat e mbledhura në nivel kombëtar duhet të ndahen në mënyrë të barabartë [të drejtë] ndërmjet sferave të qeverisjes kombëtare, provinciale dhe lokale. Pjesa e barabartë e pushtetit lokal ka për qëllim të sigurojë që komunat mund të ofrojnë shërbime bazë dhe të zhvillojnë fushat e tyre të përgjegjësive. Shuma që merr një komunë shpërndahet përmes formulës tashmë të përcaktuar për shpërndarje, komunat e vogla marrin vetëm një pjesë të vogël të buxhetit të tyre operativ nga shpërndarja e barabartë.

**Partneritetet Publiko/Private** - Kostot kapitale mund të paguhen me anë të partneriteteve ndërmjet sektorit privat dhe komunës. Në shumicën e rasteve partneri i sektorit privat do të ketë një motiv profiti për shërbimet dhe kapitalin që financohet, ndaj duhet të përcaktohen me kujdes termat dhe kushtet, për të mbrojtur interesat e komunitetit. Në sektorin e energjisë një lloj investimi i tillë njihen si kontratat e KSHE-ve. Kosova është në fazën fillore të krijimit të një tregu të KSHE-ve, edhe pse po bëhen hapat e parë për miratimin e legjislacionit dytësor.

**Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)** – është themeluar në bazë të Ligjit për EE nr. 06/L-079, si subjekt juridik i pavarur, i qëndrueshëm dhe jo fitimprurës, për të ushtruar rolin e financuesit kryesor të projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e eficiencës së energjisë në nivel komunal. Në këtë mënyrë FKEE ndihmon Komunat në zbatimin e Planeve Komunale të Eficiencës së Energjisë që kontribuon në arritjen e objektivave kombëtare në EE dhe BRE. Në këtë kontekst, PKVEK është dokument edhe më gjithëpërfshirës dhe afatgjatë në krahësim me Planin Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, autoritetet komunale duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre/trajnojnë menaxherët komunalë të energjisë në fushën e energjisë dhe ER që të janë në gjendje të hartojnë në mënyrë adekuate projekte, të cilat mund të mbështeteten nga FKEE. Fondi është mekanizëm

rrotullues dhe komunat po e kthejnë investimin nëpërmjet kursimeve të energjisë nga projektet e realizuara.

**Kreditë e jashtme** - Kreditë e jashtme (nga një bankë ose institucion tjetër finansiar) janë një formë e shtrenjtë e financimit të buxhetit kapital. Për projektet energetike në shumicën e rasteve kostoja e investimit paguhet nëpërmjet kursimeve të energjisë. Bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 Komuna ka të drejtë të ketë qasje në financimin e borxhit për investime kapitale. Ministria e Financave dhe Transfereve autorizon huamarrjen komunale me paraqitjen e kërkesës me shkrim nga kryetari i komunës pas miratimit të vendimit për huamarrje nga kuvendi komunal. Shuma e përgjithshme e huamarrjes, përfshirë interesin dhe pagesën e principalit, nuk duhet të kalojë pesëmbëdhjetë për qind (15%) të të hyrave të përgjithshme vetanake të komunës nga viti paraprak fiskal, ose shumën totale të borxhit të papaguar të komunës, duke përfshirë edhe huamarrjen e propozuar, nuk mund të kalojë pesëdhjetë për qind (50%) të të hyrave vetanake të komunës nga viti fiskal paraprak.

**Financimi nëpërmjet sektorit bankar vendor** – linjat e investimit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit me synim uljen e ndikimit mjedisor duke integruar dhe zbatuar projekte për mbrojtje të mjedisit në një sistem operativ gjithëpërfshirës që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kursimin e energjisë dhe reduktimin e CO<sub>2</sub>.

Një nga këto linja është kredia ECO e nisur nga Procredit Bank, e cila synon financimin e investimeve për të promovuar përdorimin efikas dhe kursimin e energjisë në sektorin e biznesit dhe atë të amvisërisë.

Bankat e tjera komerciale kanë edhe linjat e tyre të cilat më së shumti i targetojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe familjet.

#### ***RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE ÇËSHTJET NDËRSEKTORIALE***

Fushatat e përgjithshme ndërgjegjësuese janë të nevojshme për të ndihmuar përdoruesit fundorë të kuptojnë çështjet që lidhen me konsumin e energjisë dhe ndryshimet klimatike, si dhe t'i informojnë ata mbi veprimet e mundshme të kursimit të energjisë dhe përfitimet pasuese. Pa një nivel të caktuar ndërgjegjësimi, mundësia është e vogël për të arritur një nivel të konsiderueshmë të marrjes së programeve të tjera, më shumë teknike. Fushatat ndërgjegjësuese dhe informuese rrisin efektivitetin e instrumenteve të tjera të politikave dhe duhet të jenë pjesë e çdo pakete të ndërhyrjeve përfiqencën e energjisë.

Tjetër faktor me rëndësi në nivel lokal është për t'i bërë politikëbërësit dhe përdoruesit fundorë më të vetëdijshëm për konsumin e tyre aktual të energjisë, në mënyrë që ata të ndryshojnë veprimet ose sjelljen e tyre për të kursyer energji. Reagimet e drejtpërdrejta mbi masat dhe shpërndarjen e informacionit për reduktimin e konsumit të energjisë janë jetike për të shfrytëzuar potencialin e plotë të kursimit të energjisë.

Masa konsiston në fushata ndërgjegjësuese, organizimin e kurseve të trajnimit, hartimin e manualeve dhe broshurave, publikimeve, përveç kësaj, programi mund të kombinohet përmes konsultimit dhe pjesëmarrjes (p.sh. grupe drejtuese dhe shumë palëshe, forume, konferanca, seminare, duke përdorur TV-të lokale, reklamat). Mjetet dhe procedurat për integrimin e çështjeve ndërsektoriale në mbështetjen e përgjithshme buxhetore, huadhënien e bazuar në programe dhe/ose qasjet në të gjithë sektorin, zakonisht janë të kufizuara.

Element tjetër që duhet të mbetet strategjik, i synuar dhe i vazhdueshëm është që barazia gjinore të integrohet në të gjithë sektorët. Ndërgjegjësimi për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në efiqencën e energjisë dhe BRE-ve do të përfshihet në këto nisma. Qasja mundet dhe duhet të përfshijë aktivitete të lidhura me gjininë si; trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i njohurive, ndryshimi i qëndrimit dhe sjelljes në lidhje me uljen e konsumit të energjisë, përmirësimin e EE-së dhe aplikimin e ER-së.




Fig. 5-6 Ngritja e vetëdijësimit për implememtimin e masave EE dhe BRE

Në këtë kuptim, 40% e kërkesës për energji në Kosovë konsumohet nga ekonomitë familjare/qytetarët, prandaj mundësia më e madhe për kursim të energjisë vjen nga ky sektor.

Rekomandimet për rritjen e ndërgjegjësimit mund të ndahen në fusha të ndryshme; duke kërkuar bashkëpunim me autoritetet publike dhe partnerët socialë për të kontribuar në adresimin e sfidës sociale të eficencës së energjisë, disa nga këto aspekte janë;

- Zhvillimi i një platforme për angazhimin e pushtetit lokal në zhvillimin e politikave rajonale ose kombëtare përmes përfaqësimit të pushtetit lokal në forumet ndërreveritare, në shumicën e rasteve kjo mund të bëhet përmes kolegjumeve të AKK-së ose EE-së.
- Trajnimi dhe informimi i liderëve politik Eficiencia, qasjet më të qëndrueshme të zhvillimit, shpesh shihen si pengues të zhvillimit ekonomik lokal.
- Ndërgjegjësimi i zhvillimit dhe të kuptuarit e ndikimeve, afatshkurtra dhe afatgjata, është i rëndësishëm.
- Mobilizimi dhe përfshirja e qytetarëve: promovimi i veprimeve për përdorimin e përgjegjshëm të resurseve.
- Ndarja dhe shpërndarja e qëllimeve dhe arritjeve personale për eficencën e energjisë nëpërmjet internetit, rrjeteve sociale dhe aplikacioneve celulare.
- T'u ofrojë qytetarëve mjete që u mundësojnë të kuptojnë mënyrat e reduktimit të konsumit të energjisë në jetën e tyre të përditshme.
- Ofrimi i informacionit për qytetarët që synon ndryshimin e shpehive: ofrimi i veprimeve specifike dhe shpjegimi i përfitimeve të tyre.

Veprimi tjetër është thyerja e miteve dhe barrierave, promovimi i njohurive.

- Rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet e prekshme të arritura nga përdorimi i teknologjive më efikase për të motivuar ndryshimin - autoriteti lokal mund të bëhet një model për qytetarët.
- Ndërlidhja e eficiencës së energjisë me cilësinë dhe inovacionin, jo me përpjekjet dhe humbjen e komoditetit.
- Inkurajimi për zbatim të sjelljeve efikase tek të gjithë qytetarët, përmes standardizimit dhe praktikave të përditshme. Është thelbësore të kapërcehet bariera e injorancës dhe ngurrimi ndaj ndryshimit.
- Ndihmoni qytetarët të kuptojnë konsumin e energjisë të pajisjeve të ndryshme në shtëpitë e tyre.
- Përfitonin nga mundësitë për të instaluar njehsorë inteligjentë, të cilët ndihmojnë në zërthimin e konsumit të energjisë në shtëpi, të promovoni politika dhe veprime për të rritur eficiencën e energjisë, veçanërisht në sistemet e ngrohjes qendrore.
- Promovimi i modeleve novatore të financimit lokal (kur është e mundur) për të zhvilluar dhe nxitur tregun lokal.
- Promovimi i aksesit në eficiencën e energjisë nga komunitetet e pafavorizuara.
- Edukoni qytetarët në mënyrë që ata të kenë një këndvështrim global për rëndësinë e veprimeve të tyre. Sfida e eficiencës së energjisë është në duart e të gjithë neve, duke mos lënë anash as detajet më të vogla.
- Inkurajoni qëndrueshmërinë dhe konsumin e përgjegjshëm për të fuqizuar ndryshimin e sjelljeve, duke shmangur efektin rikuperues me përmirësimin e situatës ekonomike.
- Mësoni nga qytetarët që veprojnë në mënyrë të përgjegjshme për të promovuar veprime për eficiencën e energjisë që të motivojnë pjesën tjetër të shoqërisë.
- Mbështetni idenë se kompania vendore, përveç rritjes së ndërgjegjësimit të punëtorëve, është edhe një forcë për ndryshim.
- Promovimi i veprimeve të përgjegjshme nga ana e pushtetit lokal dhe bizneseve, të cilat duhet të shërbejnë si shembull.

Disa nga mjetet e tjera rregullatore që mund të përdoren janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tab. 5-1 Mjetet rregullative në nivelin lokal

INSTRUMENTET E POLITIKAVE NË DISPOZICION TË AUTORITETIT LOKAL	Ndërtesar private		Ndërtesar publike		Transporti	Bujqesia
	Të reja	Të rinovuara	Të reja	Të rinovuara		
Aplikimi i rregulloreve të performancës së energjisë	X	X	X	X	-	-
Stimujt finansiarë/mekanizmi mbështetës	+	+	X	X	+	+
Informacioni dhe trajnimet	X	X	X	X	+	+
Promovimi i sukseseve/udhëheqja me shembuj (modele)	+	+	X	X	+	+
Ndërtesar demonstruese/pilotimi	X	+	X	X	+	+

Promovimi i auditimeve të energjisë/çertifikimit të energjisë në ndërtesa	+	+	X	X	-	-
Planifikimi urban dhe rregulloret lokale	+	-	+	-	+	+
Rritja e shkallës së rinovimit	-	X	-	X	-	+
Koordinimi i politikave me nivelet e tjera të autoritetit	X	-	X	-	X	X
Procesi i lejeve në ndërtesa	X	+	X	+	-	-

X – Më të rëndësishmet + = Deri diku të rëndësishme - = Me rëndësi të vogël

## 6. MONITORIMI, VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi, verifikimi dhe raportimi është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit. Monitorimi i rregullt i ndjekur nga përshtatjet adekuate të planit mundëson fillimin e një përmirësimi të vazhdueshëm të procesit. Komunat janë të detyruara të paraqesin një ‘Raport të Zbatimit’ çdo vit pas Adaptimit të planit ‘për qëllime vlerësimi, monitorimi dhe verifikimi. Një udhëzues specifik i monitorimit verifikimit raportimit është zhvilluar sipas metodologjisë nga poshtë-lart për monitorimin dhe raportimin i mbështetur nga mjeti i PMV-së.

Megjithatë, nëse autoriteti lokal konsideron se një raportim i tillë i rregullt ushtron shumë presion mbi burimet njerëzore ose financiare, ai mund të vendosë ta kryejë raportimin nën ombrellën e bashkëpunimit ndërkunal, ku një komunë më e madhe mbështet komunën e vogël në këtë detyrë.

Raporti i Zbatimit përban informacion sasior mbi masat e zbatuara, ndikimet e tyre në konsumin e energjisë dhe emetimet e CO<sub>2</sub>, dhe një analizë të procesit të zbatimit të PKVEK-së, duke përfshirë masat korriguese dhe parandaluese kur kjo kërkohet.

Mjeti i miratuar i monitorimit dhe verifikimit për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë është Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit (MVP), e cila synon të monitorojë sistematikisht kursimet e energjisë si rezultat i zbatimit të planeve dhe programeve të politikave të eficiencës së energjisë si dhe planeve për reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>. Aplikacioni përfaqëson një regjistër të unifikuar në të cilin është e mundur të monitorohet zbatimi i një numri të pacaktuar planesh në nivele të ndryshme administrative të qeverisjes (kombëtare, rajonale, lokale...).

Registri i projekteve të zbatuara përfshin ruajtjen e të dhënave të mëposhtme:

- Kursimi i energjisë
- Reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub>
- Kostot e masave të zbatuara (aty ku janë të disponueshme)

Ky ueb aplikacion përdor një metodologji nga poshtë-lart, bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian, e cila është miratuar për kushtet që janë valide në çdo vend nga rajoni i EJL. Është e rëndësishme të përmendet se rezultatet ose matjet e sakta dhe përrlogaritja e detajuar e konsumit të energjisë para dhe pas zbatimit të masave duhet të përdoren sa herë që është e mundur.

Përndryshe, kur matjet para dhe pas zbatimit të masës nuk janë të disponueshme, përdoren vlerat e referencës të përshkruara në Metodologji.

Është e mundur të monitorohet zbatimi i masave në sektorët e mëposhtëm përmes PMV-së:

- Ndërtesat (duke përfshirë ndriçimin publik),
- Industrinë,
- Transportin,
- Tjera.




Fig. 6-1 Platforma per Monitorim dhe Verifikim (MVP)

Monitorimi i rregullt duke përdorur treguesit përkatës, i ndjekur nga rishikimet adekuate të PKVEK-së lejon të vlerësohet nëse autoriteti lokal po i arrin objektivat e tij dhe të miratojë masa korrigjuese nëse është e nevojshme. Prandaj, autoritetet komunale janë të përkushtuara që të dorëzojnë një "Raport Monitorimi" çdo të dytin vit pas dorëzimit të PKVEK-së. PKVEK duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër mbi atëse si autoriteti local synon të sigurojë përcjelljen e veprimeve dhe të monitorojë rezultatet dhe duhet të vazhdojë të monitorojë dhe raportojë mbi progresin për të arritur objektivat e vitit 2030.

Raporti i plotë, përveç një përshkrimi të detajuar të të gjitha masave të zbatuara dhe rezultateve të arritura, duhet të përmbajë Inventarin e Monitorimit të Emetimeve (IME). Raportimi i plotë, përmes IME-së, lejon analizimin e evolucionit në termat e konsumit të energjisë, prodhimit të energjisë dhe emetimeve të CO<sub>2</sub> në krahasim me IBE: në këtë mënyrë ai ofron një kuptim më të thellë të rezultateve të dhëna nga PKVEK dhe lejon përcaktimin e masave korrigjuese dhe parandaluese kur kjo kërkon.

Krahasimi ndërmjet Inventarit Bazë të Emetimeve (IBE) të vitit bazë me ndonjë IBE të cilido vit, më vonë do të vërtetojë në fakt reduktimin aktual të CO<sub>2</sub> në Komunë dhe do të japë një përgjigje nëse zbatimi i PKVEK ka qenë apo nuk ka qenë i suksesshëm.

## 7. MËSIMET E NXJERA DHE VLERËSIMI

Nuk duhen humbur mundësitë për të ulur konsumin e energjisë me kosto më të ulët. Në komunat me shkallë të lartë të ndërtimeve të reja ose me jetëgjatësi të shkurtër të ndërtuesave, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet promovimit të eficencës së energjisë për ndërtesat e reja. Në komunat me blloqe ndërteshash më të vjetra dhe të dëmtuara, ndërtuesat ekzistuese mund të rezultojnë të janë me prioritet kyç. Po kështu, komunat me sektorë të zgjeruar të shërbimeve do të bënë mirë të merrnin parasysh eficencën e energjisë në ndërtesat komerciale, dhe për Komunat me sektorë publikë në rritje, eficiencia e energjisë së ndërtesave publike mund të jetë një objektiv i rendësishëm.

Pasi të janë caktuar objektivat prioritare, disa politika mund të janë më të përshtatshme se të tjera, në varësi të kushteve lokale. Ndër kriteret e rendësishme janë niveli i zbatimit të kërkesave të detyrueshme, niveli i ekspertizës së profesionistëve lokalë të ndërtimit, rendësia e sektorit të vetëndërtimit, situata në lidhje me pronësinë e ndërtesave dhe performanca e shërbimeve publike.

Faktorët e identifikuar për financimin dhe zbatimin e suksesshëm të politikave dhe masave lokale për eficencën e energjisë përfshin një nevojë të identifikuar për kursim të energjisë për shkak të kostove të larta të burimeve. Bazuar në shpenzimet në rajon, një nga parimet bazë për zbatim të suksesshëm është me sa vijon.

- Ekzistenza e legjislacionit, normave dhe standardeve, programeve dhe politikave qeveritare të përshtatshme.
- Mbështetja e programeve për autoritetet rajonale dhe komunale nga Qeveria.
- Gatishmëria e menaxherëve të kompanisë/organizatës për të zbatuar përmirësimë të eficencës së energjisë.
- Niveli i lartë i rentabilitetit të projektit; - auditimet e energjisë dhe zbatimi i menaxhimit të energjisë.
- Mbështetja nga donatorët ndërkombëtarë, mundësia për të shlyer shërbimin e kredive me kursime të gjeneruara nga përmirësimi i eficencës.




Fig. 7-1 Hapat rrith mësimeve të nxjerra dhe vlerësimin

Kur bëhet fjalë për vlerësimin, disa aspekte të kursimit të energjisë dhe reduktimit të energjisë pas zbatimit mund të mos përputhen me aspektet fillestare të planifikimit, më poshtë janë disa nga mësimet e nxjerra nga zbatimi i masave të EE-së në nivel lokal:

- Shumë aktivitete të EE-së ndikojnë në pajisjet dhe sistemet e vendosura, por nuk ndikojnë në mënyrën se si përdoret pajisja ose ndërtesa (p.sh. orët që një pajisje ka qenë duke punuar). Për aktivitete të tillë, orët e punës apo treguesit e tjerë se si përdoret pajisja janë ndër variablat e pavarur që duhet të merren parasysh në kalkulimin e kursimeve. Kushtet e funksionimit për përcaktimin e konsumit bazë janë kushtet e funksionimit pas instalimit.
- Aktivitete të tjera të EE-së, të tillë si instalimi i sistemeve të kontrollit të pajisjeve ose praktikat e reja të funksionimit, ndikojnë në mënyrën se si përdoren pajisjet ose ndërtesat. Për këto aktivitete, modeli i funksionimit për përcaktimin e konsumit bazë përbëhet nga praktikat që do të ishin zbatuar gjatë periudhës pas instalimit pa efektin e aktivitetit të EE-së. Në këto raste, variablat e pavarur që janë të rëndësishme për t'u kontrolluar mund të janë për shkak të nivelit të aktivitetit në objekt, në vend të kohës së funksionimit të pajisjes. Meqenëse koha e funksionimit të pajisjes ndikohet nga aktiviteti EE-së, ajo nuk është variabël i pavarur. Për shembull, nëse ndriçimi eficient i instaluar nuk ndikon në orët e përdorimit të ndriçimit, konsumi bazë llogaritet për orët e përdorimit pas instalimit. Nëse aktiviteti eficient i ndriçimit përfshin kontolle të reja për të reduktuar orët e përdorimit të ndriçimit, konsumi bazë llogaritet për orët e përdorimit të ndriçimit që do të kishin ndodhur në harkun kohor pas instalimit në mungesë të kontrolleve të reja.
- Nëse orët e funksionimit të ndërtesës janë të ndryshme ndërmjet periudhës para dhe pas instalimit, orët e përdorimit të ndriçimit për llogaritjen bazë të konsumit bazohen në orët e përdorimit që do të kishin ndodhur në periudhën pas instalimit, nëse kontrolllet e ndriçimit nuk kanë qenë të pranishëm.

Sic pëershruhet, një nga faktorët kryesorë për vlerësimin e zbatimit të planit është dokumentimi dhe matja e kursimeve të energjisë së një programi për të përcaktuar se deri në çfarë shkalle i ka përbushur qëllimet e tij, p.sh. a ka pasur përdorim efikas të investitorit apo parasë publike? Kuptioni pse program ka japur rezultate të tille dhe identifikoni mënyrat për të përmirësuar programet aktuale dhe të ardhshme, si dhe zgjidhni programet për të ardhmen.

“Gjërat që maten kanë prirje për t'u përmirësuar.”

## 8. LISTA E MASAVE POTENCIALE

Sipas metodologjisë së KE-së dhe rekondimeve për përgatitjen e PKVEK-së, një përbledhje e masave të mundshme për të reduktuar emetimet e CO<sub>2</sub> deri në vitin 2030, në nivel Komunal përfshin masat e eficiencës së energjisë dhe BRE-ve për sektorin e ndërtesave, transportin, shërbimet publike, agronominë dhe ndriçimin publik.

Masat dhe aktivitetet për sektorin e ndërtesave ndahen në pesë nënkatgoritë e mëposhtme:

- Masat e përgjithshme për reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> për sektorin e ndëresave;
- Masat promovuese dhe aktivitetet informuese dhe edukative;
- Masat për objektet banesore dhe publike në pronësi të Komunës;
- Masat për sektorin e ndërtesave të banimit;
- Masat për ndërtesat komerciale dhe të shërbimit

DRAFT TEMPLATE

Tab. 8-1 Masat EE dhe BRE në sektorin e ndërtimit

Sektori i ndërtimit	Masa	Përshkrimi
Masat e përgjithshme	Edukimi dhe ndryshimi i sjelljeve të punonjësve/përdoruesve të ndërtimit në pronësi të komunës	<p>Kjo masë përfshin një sërë aktivitetesh edukative që kërkojnë përpjekje të vazhdueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i punëtorive edukative për kursimin e energjisë;</li> <li>Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve edukative (fletushka, postera, afishe, etj.)</li> <li>Organizimi i paneleve të diskutimeve dhe ngjarjeve të ngjashme</li> </ul> <p>Krahas aktivitetave edukative të parapara në kuadër të kësaj mase, lind nevoja e futjes së një marrëveshje stimuluese për kursimin e energjisë (p.sh. marrëveshja 50/50) në kuadër të të cilës një pjesë e fondit finanziar që vjen nga kursimet e realizuara të energjisë mbetet në dispozicion të institucioneve individuale në të cilat janë realizuar kursimet.</p> <p>Kursimi i energjisë i arritur nga zbatimi i masave që synojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve të ndërtimit në pronësi të komunës është mjaft i vështirë për t'u llogaritur. Bazuar në përvojat e qyteteve të tjera evropiane, ekziston mendimi se aktivitetet e vazhdueshme edukative për promovim dhe informim gjatë 5 viteve në vijim mund të rezultojnë në 5% kursum të energjisë elektrike dhe termike në ndërtimet në pronësi të komunës krahasuar me konsumin në vitin bazë.</p>
	Edukimi dhe promovimi i eficiencës së energjisë për qytetarët	<p>Kjo masë përfshin disa aktivitete që do të zbatohen rregullisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Vendosja e këndeve të informacionit për EE në pjesë të ndryshme të Komunës;</li> <li>Informacion i vazhdueshëm ndaj klientit në lidhje me kursimin e energjisë dhe çështjet aktuale të lidhura me energjinë në pjesën e pasme të faturave të energjisë;</li> <li>Organizimi i fushatave promovuese dhe informuese për tematika specifike për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me eficiencën energetike të ndërtimit: <ul style="list-style-type: none"> <li>Si të ndërtohet një shtëpi me EE?</li> <li>Rikonstruimi i ndërtimit në përputhje me parimet për një ndërtim të qëndrueshme;</li> <li>Certifikatat energetike – konsumi i energjisë si kategori tregu në blerjen, marrjen me qira dhe riparimin e ndërtimit;</li> <li>“Ndryshimi i sjelljes së qytetarëve” ndaj kursimit të energjisë</li> <li>Masat për eficiencë energetike në familje– valvola termostatike, sisteme diellore për përgatitjen e ujit të ngrrohtë sanitar, zdrukthtar me eficiencë energetike, elektroshtëpiake me etiketë energetike “A+++”;</li> <li>Etiketimi i eficiencës së energjisë - Pse të blini vetëm pajisje të klasës energetike</li> </ul> </li> </ol>

		<p>A+++?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Modaliteti ‘standby’ konsumon gjithashtu energji elektrike! – fikja e pajisjeve shtëpiake nga rrjeti i energjisë pas përdorimit;</li> <li>• Ndriçimi i brendshëm me eficiencë energetike;</li> <li>• Ngrohja me biomasë;</li> <li>• Kolektorët diellorë;</li> <li>• Pompat ngrohëse;</li> <li>• Ndërtesat inteligjente – çfarë është ajo?;</li> <li>• Çfarë janë shtëpitë me konsum të ulët të energjisë ;</li> <li>• Çfarë është shtëpia pasive;</li> <li>• Çfarë është <i>Faktori 10</i><sup>1</sup>;</li> </ul> <p>4. Organizimi i takimeve për të promovuar përdorimin racional të energjisë dhe reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>:</p> <p>Kursimi i energjisë duke zbatuar masa që përfshijnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme të synuara është e vështirë të matet.</p>
Paketa e instrumenteve për të promovuar instalimin e kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit	Zbatimi i suksesshëm i Projektit të Ngrohjes Diellore të Ujit në ndërtesat në pronësi të komunës do të rezultojë në një rritje të përdorimit të ngrohjes diellore të ujit në ndërtesat komunale dhe në këtë mënyrë në një reduktim të madh të konsumit të energjisë elektrike për ngrohjen e ujit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informimi i konsumatorëve për kursimet e vazdueshme të energjisë në rast të instalimit të kolektorëve diellorë</li> <li>• Organizmi i fushatave promovuese dhe informuese:</li> <li>• Takime për të promovuar përdorimin racional të energjisë dhe reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në rastin e instalimit të kolektorëve diellorë:</li> <li>• Kursimi i energjisë duke zbatuar masa që përfshijnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme të synuara</li> </ul>
Rrjeti Këshillues për Energjinë - Qendrat Informativë për Eficiencën e Energjisë	Zbatimi i një Rrjeti të Këshillimit për Energjinë është një “vazhdim” i domosdoshëm i fushatave ndërgjegjësuese, të ndërtuara hap pas hapi. Në hapin e parë do të ndërtohen qendra informacioni për familjet .	
Edukimi dhe trajnimi i	Drafti i Ligjit për Eficiencën e Energjisë tashmë parashev auditime energjetike. Edukimi i zyrtarëve	

<sup>1</sup> Faktori 10 nënkupton se gjatë 30 - 50 vitet e ardhshme duhet të ketë një rënje në konsumin e energjisë me një faktor prej 10 dhe një rritje në produktivitetin/eficiencën e burimeve me një faktor prej 10.

Ndërtesat në pronësi të komunës	mëtejshëm për profesionistët e energjisë	komunalë dhe promovimi i ngritjes së kapacitetave për profesionistët në sektorin e ndërtimit (projektues dhe punëtorë ndërtimi), që do të thotë se duhet të zhvillohen kurse të specializuara të trajnimit. Gjithashtu, do të zhvillohen procedurat e licencimit për edukim të mëtejshëm.
	Performanca e Energjisë Skema e certifikimit në ndërtesa	Në përputhje me kornizën ligjore të hartuar (Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Rregullorja përkatëse MMPH Nr. 03/18 e Procedurave për Çertifikimin e Performancës Energjetike të Ndërtesave), duhet të futet një skemë e certifikimit të ndërtesave në mënyrë që konsumi i energjisë në ndërtesa të bëhet më transparent për klientët dhe/ose qiramarrësit.
	Prezantimi Sistemit te Menaxhimit te Energjise në Komuna	Autoritetet komunale do të krijojnë një sistem të menaxhimit të energjisë në nivel komunal me qëllim: identifikimin e konsumit të energjisë - monitorimin e vazhdueshëm të modelit të konsumit të energjisë, planifikimin dhe zbatimin e masave të eficiencës së energjisë, verifikimin dhe vlerësimin e arritjeve në ndërtesat në pronësi të Komunës.
	Promovimi i instalimit të kolektorëve diellorë për ngrohjen e ujit në ndërtesat në pronësi të Komunës	Ndërtesat në pronësi të komunës (qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ndërtesat administrative) rekomandohen të instalojnë kolektorët diellorë për ngrohje të ujit. Ngrohësit ekzistues në ndërtesat e përmendura janë të gjithë elektrikë.
	Modernizimi i sistemit të ndriçimit në ndërtesat publike në pronësi dhe në përdorim të Komunës	Rregullorja e BE-së për produktet e ndriçimit (Rregullorja KE 244/2009) parashët që deri në vitin 2016 të ndërpritet prodhimi i llambave tradicionale inkandeshente, duke rezultuar në zëvendësimin e tyre me llamba të kursimit të energjisë. Kjo masë synon zëvendësimin e llambave konvencionale me llambat e kursimit në të gjitha ndërtesat në pronësi të komunës. Edhe në rastin e llambave fluoreshente efikase, rekomandohet zëvendësimi i tyre me llamba akoma më efikase dhe më jetëgjata si llambat LED.
Instalimi i sistemit të rregullimit të nxehësisë (termometrave) në të gjitha objektet në pronësi dhe në përdorim të Komunës me sistem të ngrohjes qendrore të instaluar	Instalimi i sistemit të rregullimit të nxehësisë (termometrave) në çdo dhomë (zyra, salla takimesh, etj.) që mundëson rregullimin e temperaturës, furnizimin e duhur me ajër të pastër dhe rregullimin e sistemeve të ngrohjes/ftohjes.	
	Termoizolimi i mbështjellësit të objekteve në pronësi të Komunës	Izolimi termik i plotë me mbështjellës i të gjitha ndërtesave në pronësi të Komunës. Rekomandohet që prioritet në termoizolim t'u jepet institucioneve që kanë nevojë për rindërtim .
	Instalimi i dritareve me performancë të lartë dhe me eficiencë energjetike në një numër të caktuar ndërtesash në pronësi të Komunës.	Instalimi i dritareve me performancë të lartë dhe me eficiencë energjetike në një numër të caktuar ndërtesash në pronësi të Komunës. Rekomandohet jashtëzakonisht shumë që të bëhet zbatimi i njëkohshëm i kësaj mase së bashku

	<b>ndërtesat në pronësi të Komunës</b>	me masën e mësipërme (izolimi termik me mbështjellës).
	<b>Instalimi i valvulave termostatike në radiatorë në të gjitha ndërtesat në pronësi të Komunës</b>	Kjo masë parashev vendosjen e valvulave termostatike në ndërtesat në pronësi të Komunës. Bazuar në rezultatet e marra nga auditimet e shumta të energjisë në ndërtesat publike, numri mesatar i radiatorëve është 0,0517 radiatorë/m <sup>2</sup> , ose 1 radiator për 20 m <sup>2</sup> . Prandaj, kjo masë duhet të përfshijë instalimin e termostateve në të gjithë radiatorët.
	<b>Prezantimi i kritereve të prokurimit publik të gjelbër për blerjen e pajisjeve të konsumit të energjisë dhe pajisjeve tjera</b>	Kjo masë synon stimulimin e blerjes së aparateve me eficiencë energetike për nevojat e të gjitha ndërtesave në pronësi të Komunës nëpërmjet futjes së politikës së Prokurimit Publik të Gjelbër. Kriteret për blerjen e pajisjeve të tillë duhet të përcaktohen më herët dhe të standardizohen në një mënyrë që kostoja e ciklit jetësor të merret parasysh në vend të kostos fillestare.
	<b>Zëvendësimi i kaldajave të vjetra ekzistuese (kaldaja me naftë, linjët dhe kaldaja elektrike) me kaldaja të reja shumë efikase me pelet, pompa ngrohëse ose kaldaja me kondensim në ndërtesat në pronësi të komunës</b>	Regullorja e BE-së në lidhje me burimin e energjisë (Regullorja e KE-së 2009/28/EC) parashev që linjiti nuk mund të përdoret si lëndë djegëse parësore për stacionet e ngrohjes qendrore për shkak të ndotjes së lartë të CO <sub>2</sub> . Kjo masë synon zëvendësimin e kaldajave të vjetra me naftë, kaldajave me linjët dhe kaldajave elektrike me kaldaja me eficiencë të lartë të energjisë që funksionojnë me biomasë, ose pompa ngrohëse ose kaldaja me kondensim. P.sh.: Kjo masë zgjedhon 10-15% të konsumit të energjisë termike si rezultat i eficiencës më të mirë të kaldajës duke përdorur biomasën si lëndë djegëse parësore.
	<b>Promovimi i potentialit për subvencionimin e ndërtesave me konsum pothuajse zero të energjisë - NKPZE</b>	Vendosja e kushteve për masa stimuluese për përmirësimin e termoizolimit në ndërtesat e sektorit komercial dhe të shërbimeve në Komunë në përputhje me standartet e NKPZE-së. Përpara zbatimit të masës, një analizë e detajuar është thelbësore për të përcaktuar statusin, perspektivën dhe mjetet e zbatimit. Bazuar në përvojën ndërkombëtare, kursimi i energjisë termike vlerësohet të jetë rreth 60%.
<b>Sektori i banimit</b>	<b>Skema stimuluese për rinvimin e plotë të blloqueve shumëbanesore</b>	Skema e subvencionimit bazohet në kriterin e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- cilësia termike minimale për marrjen e subvencionit;</li> <li>- rritja e subvencionit me përmirësimin e cilësisë termike pas rinvimit;</li> <li>- në sektorin e bashkëpronësisë: mbështetje sociale shtesë për familjet me të ardhura të ulëta</li> </ul> Pjesa mbizotëruese e ndërtesave shumëbanesore NSH përbëhet nga ndërtesa të bashkëpronësisë

		<p>dhe pronarët e banesave nuk janë në gjendje të mbulojnë të gjitha kostot për rrinovimin e plotë të NSH-ve, e cila zakonisht është pengesë kryesore për rrinovim ose çon në rrinovim me cilësi të ulët. Prandaj, skemat e subvencionimit janë instrumente të rëndësishme për rritjen e shkallës së rrinovimit termik.</p> <p>Me zbatimin e masave të EE-së në mbështjellësin e ndërtesave dhe sistemin e ngrohjes, kursimi specifik i energjisë do të jetë përafërsisht. 149 kWh/m<sup>2</sup>a, (izolimi i fasadës, çatisë dhe ndërrimi i dritareve ).</p>
	Skema stimuluese për instalimin e kolektorëve diellorë në ndërtesat ekzistuese të banimit	<p>Arsyetimi ekonomik dhe kthimi relativisht i favorshëm i investimit mund të arrihet nëpërmjet kërkesës së madhe për ujë të ngrohtë në baza ditore dhe vjetore.</p> <p>Për të arritur një zbatim efikas të kësaj mase nevojiten hapat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Subvencione mbi 15% nga buxheti i komës ose/dhe institucionë të ndryshme financiare</li> <li>• Institucionet akademike dhe shkencore duhet të zhvillojnë projekte të zbatueshme për të ndihmuar prodhuesit vendorë të pajisjeve,</li> <li>• Të themelohen dhe akreditohen laboratorët për të testuar cilësinë e pajisjeve të produhuara,</li> <li>• Të organizohet një fushatë informuese për t'u mundësuar konsumatorëve të njihen me cilësinë e pajisjeve të ofruara dhe përfitimet e përdorimit të tyre.</li> </ul> <p>Kursimi i energjisë nga këto masa do të jetë 550 kWh/m<sup>2</sup> të sipërfaqes diellore. Së fundi, përshtëpi të zakonshme mund të montohen panele diellore afërsisht 4m<sup>2</sup>.</p>
	Instalimi i sistemeve të ngrohjes me pelet me eficiencë të lartë të shfrytëzimit, në vend të ngrohjes elektrike në sektorin e familjeve	<p>Kjo masë synon zëvendësimin e sistemit të ngrohjes së familjeve me sisteme të reja të ngrohjes me biomasë në formë peleti. Kaldajat moderne me pelet karakterizohen me eficiencë të lartë të përdorimit, ndërsa në aspektin e emetimit peletët konsiderohen neutralë për mjedisin. Një masë e tillë rekomandohet të subvencionohet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.</p> <p>Zbatimi i kësaj mase deri në vitin 2030, nuk do të ndikojë në uljen e konsumit të energjisë por do të ketë një ndikim të madh në uljen e emetimeve të CO<sub>2</sub>, krahasuar me emetimet nga sistemet e ngrohjes elektrike.</p>
	Instalimi i llambave të kursimit në sektorin e familjeve	<p>Rregullorja e BE-së për produktet e ndriçimit (Rregullorja KE 244/2009) parashë që deri në vitin 2016 të ndërpritet prodhimi i llambave inkandeshente konvencionale, duke rezultuar në zëvendësimin e tyre me llamba të kursimit të energjisë.</p> <p>Kjo masë synon zëvendësimin e llambave konvencionale me llambat e kursimit të energjisë. Edhe në rastin e llambave fluoreshente efikase, rekomandohet zëvendësimi i tyre me llamba akoma më efikase dhe më jetëgjata si llambat LED.</p>
	Promovimi i potencialit për subvencionimin e	Vendosja e kushteve për masa stimuluese për përmirësimin e termoizolimit në ndërtesat e sektorit komersial dhe të shërbimeve në Komunë në përpjekje me standarde e NKPZE-së.

	ndërtesave me konsum pothuajse zero të energjisë - nZEB	Përpara zbatimit të masës, një analizë e detajuar është thelbësore për të përcaktuar statusin, perspektivën dhe mjetet e zbatimit. Bazuar në përvojën ndërkombëtare, kursimi i energjisë termike vlerësohet të jetë rreth 60%.
--	---	--

DRAFT TEMPLATE

Masat dhe aktivitetet në sektorin e transportit në Komunë ndahen në këto kategori::

- Masat rregullatore dhe planifikuese;
- Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative;
- Automjetet private dhe komerciale;
- Automjetet në pronësi të komunës;
- Transporti publik.

DRAFT TEMPLATE

Tab. 8-2 Masat EE dhe BRE në sektorin e transportit

Sektori i transportit	Masa	Përshkrimi
Masat rregullatore dhe planifikuese	Politika e parkingjeve në Komunë	Politika e parkingjeve të Komunës do të bazohet në tarifat e parkingut sipas zonave të parkimit në territorin komunal. Kjo politikë do të ndihmojë në ndryshimin e sjelljes së njerëzve kundrejt udhëtimit. Parafjala e kësaj mase është shtrirja e zonës së parkimit edhe në pjesët e tjera të Komunës. Politika e çmimeve të larta për parkingjet, së bashku me kufizimin e kohës së parkimit, bëri që përdoruesit aktualë të makinave të kalojnë në mjete të tjera transporti më efikase - transport publik ose biçikletë. Qëllimi kryesor është të dekurajohet përdorimi i makinave individuale në qytete, të reduktohet ndotja dhe të sigurohet një lëvizje më e sigurt për këmbësorët.
	Masat për përmirësimin e fluksit të trafikut në Komunë	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Fluksi i trafikut në qytet do të ndryshonte me modernizimin e transportit publik;</li> <li>b. Ndërtimi i rrugëve anësore rreth qytetit do të lehtësonte shumë trafikun dhe do të reduktoonte bllokimin e trafikut në qytet</li> <li>c. Duke i japur përparësi mjeteve të transportit publik përgjatë shiritave të veçantë;</li> <li>d. Instalimi i sistemit për dhënien e përparësisë mjeteve të transportit publik në kryqëzime; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi i disa kufizimeve për transportin e mallrave me qëllim lehtësimin e rrjetit të brendshëm të qytetit;</li> </ul> </li> </ul>
	Masat për përmirësimin e sigurisë në komunikacion	<ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rregullimi i shpejtësisë së lëvizjes duke instaluar sete të radarëve që tregojnë shpejtësinë;</li> <li>b. Vendosja graduale e sinjalistikës së trafikut LED në të gjitha segmentet e ndjeshme rrugore të qytetit.</li> </ul>
	Ndërtimi i parkingjeve për makina në hyrje të qytetit (pjesa periferike)	Vendparkimet për makina në hyrje të qytetit do të parandalonin hyrjen e shumë automjeteve në qytet gjatë ditës. Udhëtimi nga ato vendparkingje për në qendër do të ishte i mundur me autobusë të qytetit. Bileta e paguar për parkingun ditor do të përdorej për udhëtimin ditor me autobus. Me të njëjtin çmim për parking, bileta e udhëtimit do t'i jepet çdo pasagjeri të makinave.
	Ndërtimi i shtigjeve për bicikleta në qendër të komunës	Ndarja trotuareve të qendrës së qytetit në dy shtigje. Shtegu për bicikleta dhe për këmbësorë. Kjo do të sigurojë udhëtim të sigurt për bicikletat.
	Ndërtimi i vendparkimeve për bicikleta dhe motoçikleta	Parkingu për bicikleta dhe motoçikleta do të nxisë qytetarët që të shmangin përdorimin e automjeteve.

	Masat dhe aktivitetet për promovim, informim dhe edukim	<p>Masat dhe aktivitetet promovuese, informuese dhe edukative me qëllim të përmirësimit të cilësisë së transportit dhe reduktimit të emetimeve të CO2 përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Promovimi i modelit të ndarjes së makinave për rritjen e numrit të pasagjerëve;</li> <li>2. Fushata informuese dhe trajnime mbi mënyrat miqësore me mjedisin për mobilitet</li> <li>3. Promovimi i përdorimit të lëndëve djegëse alternative;</li> <li>4. Organizimi i punëtorive informative- demonstruese për qytetarët për përdorimin e automjeteve me lëndë djegëse alternative (energi elektrike, gaz natyror, biokarburant etj.) me mundësinë e marrjes me qira të automjeteve me lëndë djegëse alternative;</li> <li>5. Organizimi i paneleve, punëtorive dhe tryezave, realizimi i sondazheve dhe hulumtimeve, shpërndarja e materialeve informuese dhe promovuese etj;</li> <li>6. Fushata: Biçikleta është më e shëndetshme!</li> </ol>
Masat promovuese, informuese e edukative	Promovimi i përdorimit të lëndëve djegëse alternative	<p>Rritja e nivelit të përgjithshëm të njojurive të qytetarëve për automjetet me lëndë djegëse alternative, përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese dhe trajnimeve që demonstrojnë funksionimin e këtyre automjeteve.</p> <p>Stimulimi i blerjes së automjeteve me lëndë djegëse alternative, në shërbimet taksi me anë të subvencioneve për blerjen e automjeteve të reja.</p>
	Fushata informuese për vozitje efikase	<p>Rritja e nivelit të përgjithshëm të njojurive të qytetarëve për automjetet me lëndë djegëse alternative, përmes aktiviteteve të ndryshme promovuese dhe trajnimeve që demonstrojnë funksionimin e këtyre automjeteve.</p> <p>Stimulimi i blerjes së automjeteve me lëndë djegëse alternative, në shërbimet taksi me anë të subvencioneve për blerjen e automjeteve të reja</p>
	Fushata me moton: "Një ditë në javë pa makina"	<p>Fushata me moton "Një ditë në javë pa makina" inkurajon shoferët të udhëtojnë pa makina (ecin, përdorin bicikletën). Fushata do të fillojë afersisht me një ditë në dy muaj, duke rritur vazhdimesh shpeshtësinë e organizimit të këtyre ditëve. Në këmbim qytetarët marrin biletat të transportit publik me çmim më të ulët dhe ngjarje të tjera sociale.</p>
	Promovimi i modelit të ndarjes/marrjes me qira të makinave për rritjen e numrit të pasagjerëve	<p>Ka më shumë se 1.000.000 automjete për ndarje/marrje me qira në mbi 2.000 qytete në mbarë botën. Bazuar në këto përvoja, bëhet e qartë se një automjet i ndarë/marrë me qira zëvendëson 5-8 automjete personale. Ndarja e makinave përfaqëson përdorimin racional të automjeteve private dhe kursen para për personat që nuk kanë nevojë për automjete personale (nuk kanë nevojë të blejnë një makinë, të paguajnë të gjitha detyrimet dhe sigurimet, mirëmbajtjen.....)</p> <p>Aktivitetet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i sistemit të ndarjes/marrjes me qira të makinave si një shërbim i thjeshtë, i qasshëm me një numër minimal</li> </ul>

		<p>formularësh aplikimi, i cili kërkon vetëm pagesën për kohën dhe kilometrazhin (përdorimi aktual i automjetit), ku përdoruesit e regjistruar mund të përdorin automjetin 24 orë në ditë thjesht duke u regjistruar paraprakisht me telefon, internet ose në vend.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Futura e sistemit të ndarjes/marrjes me qira të makinave sjell të ardhura shtesë për Komunën, qoftë nga organizimi dhe ofrimi i automjeteve në sistemin e ndarjes/marrjes me qira të makinave, qoftë duke u ofruar koncesione sipërmarrësve të interesuar.</li> </ul>
	Inkurajimi për zëvendësimin e automjeteve të vjetra	Për pronarët e automjeteve të vjetra që nuk plotësojnë kriteret e emetimit të CO <sub>2</sub> , duke krijuar stimuj për zëvendësimin e automjeteve të vjetra me ato më të reja.
<b>Automjetet në pronësi/përdorim të Komunës</b>	Prokurimi Publik i Gjelbër për automjetet në pronësi të Komunës	<p>Hapi fillestar për zbatimin e masës është miratimi i Vendimit për kriteret e Prokurimit Publik të Gjelbër për automjetet në pronësi të Komunës në emër të Këshillit Komunal.</p> <p>Prokurimi Publik i Gjelbër për të gjitha automjetet në pronësi të komunës duhet të kërkojë blerjen e vetme të automjeteve me emetim të ulët CO<sub>2</sub> (&lt;120 g/km) ose karburant alternativ.</p>
<b>Transporti publik</b>	Grup masash për përmirësimin e transportit me bicikleta në qytet	<p>Grupi i masave për përmirësimin e transportit me bicikleta përfshin këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i një rrjeti bicikletash me qira, të pajisura me sistem administrimi IT, të pajisur me vendparkime për bicikleta dhe dyqane riparimi dhe rrugëmatës;</li> <li>Krijimi i sistemit të mirëmbajtjes së sistemit për bicikleta dhe shtigjeve për bicikleta në të gjithë zonën e Komunës</li> </ul> <p>Zbatimi i masës përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>shënim i pistave për bicikleta;</li> <li>Vendosja e tabelave me harta të shënuara për bicikleta;</li> <li>Reduktimi i numrit të aksidenteve të mundshme me bicikleta duke ndarë shtigjet e bicikletave nga rrugët e trafikut kudo që është e mundur;</li> <li>Vendosja e një hapësire për parkim të bicikletave të pajisura me video kamera për parandalimin e vjedhjes, në afërsi të stacionit hekurudhor ose në ndonjë vend tjetër të përshtatshëm;</li> <li>Ofrimi i mundësisë për riparim dhe sigurimi i mbajtjes së bicikletave private në hapësirën e caktuar për bicikleta;</li> <li>Blerja e bicikletave për dhënie me qira, duke pasur parasysh që bicikletat duhet të pajisen me sistemin mbrojtës kundër vjedhjes;</li> <li>Promovimi dhe nxitja e ngasjes së bicikletave veçanërisht në distanca të shkurtra;</li> <li>Mirëmbajtja e vazhdueshme e shtigjeve për bicikleta në të gjithë zonën e komunës;</li> <li>Promovimi i programeve dhe edukimit mbi përparësitë e transportit me bicikleta në kopshte, shkolla, panele për qytetarët.</li> </ul>

Masat dhe aktivitetet në sektorin e ndriçimit publik në Komunë janë si më poshtë:

Tab. 8-3 Masat EE dhe BRE në sektorin e ndriçimit publik

Ndriçimi publik	Masa	Përshkrimi
Masat e planifikimit	Zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara të ndriçimit me pajisje ndriçimi më eficiente në energji dhe miqësore me mjedisin dhe sistem të kontrollit dhe menaxhimit të ndriçimit publik	<p>Aktivitetet që duhet të zbatohen përfshijnë zëvendësimin gradual të pajisjeve të ndriçimit të vjetruara me pajisje ndriçimi moderne me karakteristikat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Efiçencë të energjisë;</li> <li>• Teknologjia optike mundëson instalimin e llambave të cilat konsumojnë më pak energji duke ruajtur të njëtin nivel ndriçimi;</li> <li>• Përbajë rregullim elektronik të ndriçimit për çdo pajisje ndriçimi.</li> </ul> <p>Pajisjet moderne të ndriçimit duhet të përbajnjë ndezës dhe rregullim elektronik, ku çdo llambë të ketë regjin e vet të ndriçimit në përputhje me kërkesat e intensitetit të ndriçimit për çdo hapësirë publike.</p>
	Instalimi i sistemit të kontrollit dhe menaxhimit të ndriçimit rrugor	<p>Masa përfshin zbatimin e Sistemit Smart për kontrollin dhe monitorimin e ndriçimit publik.</p> <p>Kërkesat minimale për këtë sistem duhet të janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulatorë e errësimit nga 0%-100%,</li> <li>• Kontrollues me GPRS i aftë për t'u programuar për periudha të ndryshme pune</li> <li>• Softuer aplikativ përmes të cilit mund të monitorohet i gjithë sistemi.</li> </ul>

Masat dhe aktivitetet në sektorin e shërbimeve publike dhe komerciale në Komunë janë si në vijim:

Tab. 8-4 Masat EE dhe BRE në sektorin e shërbimeve publike dhe komerciale

Shërbimet publike	Masa	Përshkrimi
Sektori i shërbimeve publike dhe komerciale	Prezantimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Energjisë në Sektorin e Tregtisë dhe Shërbimeve	Ndërmarrjet publike mund të krijojnë një sistem të menaxhimit të energjisë që synon: identifikimin e konsumit të energjisë - monitorimin e vazhdueshëm të modeleve të konsumit të energjisë, planifikimin dhe zbatimin e masave për efiçencën e energjisë, verifikimin dhe vlerësimin e arritjeve. Gjithashtu, rritja e vazhdueshme e çimit të energjisë elektrike do të ketë ndikime të mëdha për institucionet publike dhe do të shërbejë si model i mirë për sektorin komersial dhe atë të shërbimeve.
	Instalimi i sistemeve të ngrohjes me pelet me efiçencë të lartë	Kjo masë synon zëvendësimin e sistemit të ngrohjes të këtyre lloj ndërtesave me sisteme të reja të ngrohjes me biomasë në formë peleti. Kaldaja moderne me pelet karakterizohet me efiçencë të lartë të përdorimit, ndërsa në aspektin e emetimit peletët

	lartë shfrytëzimi, në vend të ngrohjes elektrike dhe/ose me linjët dhe/ose me naftë në sektorin komersial dhe të shërbimeve	konsiderohen neutralë për mjedisin. Një masë e tillë rekomandohet të subvencionohet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Zbatimi i kësaj mase do të zgjedhë konsumin e energjisë së sistemeve ekzistuese të ngrohjes me 10% krahasuar me konsumin në vitin bazë, ndikimin më të madh do ta ketë në reduktimin e emetimeve të CO <sub>2</sub> , krahasuar me emetimet nga sistemet e ngrohjes elektrike, me linjët ose naftë.
	Subvencionet për përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në sektorin ekzistues komersial dhe të shërbimeve	Vendosja e kushteve për masat stimuluese për përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë (prodhimi i energjisë termike, fotovoltaike). Bazuar në përvojat e deritanishme, kursimet e energjisë termike vlerësohen në 8% të konsumit total të energjisë termike në këtë nënsektor, ose mund të jetë i mundur aplikimi i FV-ve diellore për vetëkonsum deri në kapacitetin 100 kWp.
	Instalimi i llambave të kursimit të energjisë në ndërtesat e sektorit komersial dhe të shërbimeve	Rregullorja e BE-së për produktet e ndriçimit (Rregullorja KE 244/2009) parashev që deri në vitin 2016 do të pushojë prodhimi i llambave inkandeshente konvencionale, duke rezultuar në zëvendësimin e tyre me llamba të kursimit të energjisë. Kështu, zëvendësimi i llambave inkandeshente me llambat kursyese do të bëhet i detyrueshëm në të gjithë sektorin komersial dhe atë të shërbimeve.
	Miratimi i rregulloreve komunale për të stimuluar përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë për ndërtesat e reja në sektorin komersial dhe të shërbimeve	Komunat mund të ofrojnë stimuj në formën e uljes së taksave lokale gjatë dhënies së lejes së ndërtimit nëse aplikimi i EE-së dhe BRE-ve janë pjesë e projektimit kryesor. Vlerësimet sugjerojnë që me zbatimin e kësaj mase, konsumi i energjisë termike në këtë nënsektor duhet të bjerë deri në 12%.

Tab. 8-5 Masat EE dhe BRE në sektorin e bujqësisë

Bujqesia	Masa	Përshkrimi
Aparatet dhe pajisjet	Promovimi dhe aplikimi i energjisë së ripërtërishme, instalimi i kolektorëve termikë diellorë dhe fotovoltaikë	Kolektorët diellorë për ngrohjen e ujit në ferma, veçanërisht në veprimtarinë blegtoreale ku nevojitet ujë i nxeh të, për tharjen e të korrave dhe drithërave. Sistemi fotovoltaik është shumë ekonomik në sigurimin e energjisë elektrike në vende të largëta në ferma, rançë dhe veprimtari të tjera bujqësore. Sistemi PV mund të jetë shumë më i lirë se instalimi i kabllove të energjisë dhe transformatorëve në aplikime të tillë si ndriçimi i ndërtesave, pompimi i ujit, qoftë për t'i dhënë ujë bagëtive ose ujitjen e kulturave.
	Promovimi i aplikimit të motorëve me eficiencë të energjisë, motorëve me frekuencë të ndryshueshme dhe pompave me vakum për ujë të pijes për bagëti dhe përmirësimin e ujitjes	Aplikimi i motorëve lëvizës me eficiencë të lartë dhe me shpejtësi të ndryshueshme.
	Modernizimi i sistemit të ndriçimit në ndërtesat bujqësore	Kjo masë synon zëvendësimin e llambave konvencionale me llambat e kursimit të energjisë në ndërtesat bujqësore. Edhe në rastin e llambave fluoreshente efikase, rekomandohet zëvendësimi i tyre me llamba akoma më efikase dhe më jetëgjata si llambat LED. Për sistemin e ftohjes dhe ngrirjes - për përmirësimin e ndriçimit automatik me pajisje eficiente për energji për të reduktuar sasinë e energjisë së përdorur dhe nxehësinë e gjeneruar nga dritat
	Instalimi i sistemeve të ngrohjes me pelet me eficiencë të lartë shfrytëzimi, në vend të ngrohjes elektrike dhe/ose me linjët dhe/ose me naftë	Kjo masë synon zëvendësimin e sistemit ekzistues të ngrohjes me sisteme të reja të ngrohjes me biomasë në formën e peletit. Kaldaja moderne me pelet karakterizohet nga eficiencia e lartë e përdorimit, ndërsa në aspektin e emetimit peletët konsiderohen neutralë përmjedisin. Zbatimi i kësaj mase do të redukojë konsumin e energjisë në sistemet ekzistuese të ngrohjes për hapësirat ku sistemi i ngrohjes është i nevojshëm.
	Skema promovuese për aplikimin e makinerive	Informacion mbi përputhjen e kuaj-fuqisë me ngarkesat e pajisjeve, për shembull shmangja e tërheqjes së ngarkesës së lehtë me makinë me kuaj-fuqi të lartë. Trajnoni dhe motivoni stafin për kursimin e mundshëm të eficiencës

	bujqësore me efiçencë të lartë	së karburantit për të bërë një plan të thjeshtë të menaxhimit të lëndëve djegëse. Fryni gomat në presion optimal - është variabël i rëndësishëm për efiçencë e karburantit, jetëgjatësinë e gomave dhe komoditetin e udhëtimit. Mbështetja e stimujeve për zëvendësimin e makinerive të vjetra me të reja që kanë produktivitet të lartë. Kursimet e energjisë për këtë masë duhet të modelohen në bazë të masave individuale të identifikuara (nëse ka të dhëna të disponueshme).
--	--------------------------------	---